

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5943
E shtunë, 30 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Javën e ardhshme
pritet të nënshkruhet
marrëveshja qeverisëse
LV-LDK F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**HAPAT QË DUHEN NDËRMARRË
NGA TRESHJA KOMBËTARE DHE
NDIHMA NDËRKOMBËTARE F. 11**

Prof. Lisen
BASHKURTI



**SA ËSHTË E RREZIKUAR KOSOVA
NGA FATKEQËSITË NATYRORE F. 11**

Shkruan:
TAHIR AHMETI



AKTUALE



**PËRFUNDOJNË GËRMIMET NË
PRISHTINË, NUK KA MBETJE
MORTORE F. 3**

**STAFI I UP-së OFRON NDIHMË
PAS SITUATËS SË KRIJUAR NË
SHQIPËRI F. 5**

**KQZ-ja NJOFTON THAÇIN PËR
CERTIFIKIMIN E REZULTATEVE
TË ZGJEDHJEVE F. 3**

EKONOMI

**ODA AMERIKANE DHE
GJIRAF.COM NISIN
KONTINGJENTIN E PARË TË
NDIHMAVE DREJT SHQIPËRISË**

F. 9

FLET PËR "EPOKËN E RE", RRAHMAN RAMA

NDIHEMI KRENARË PËR PUNËN E FSK-së NË SHQIPËRI

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletniant Rrahman Rama, ka treguar për profesionalizmin e ushtarëve të FSK-së në operacionin e kërkim-shpëtimit pas tërmetit në Shqipëri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gjatë këtij operacioni ata kanë treguar disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm në punë. Për këtë ai ka thënë se ka marrë vlerësim të lartë nga autoritetet shqiptare dhe ato ndërkombëtare. Komandanti i FSK-së ka thënë se për punën e këtyre ushtarëve në këtë operacion duhet të ndihen krenarë të gjithë qytetarët e Kosovës



Rritet numri i viktimave nga tërmeti në Shqipëri, mbi 1 200 banesa të dëmtuara

Së paku 49 persona kanë vdekur dhe qindra të tjerë janë lënduar nga tërmetet që kanë goditur Shqipërinë që prej orëve të para të mëngjesit të

së martës. Tërmeti i 26 nëntorit me magnitudë 6.4 ballësh të Rihterit ishte më i fuqishmi që ka goditur Shqipërinë që disa dekada.

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Osmani: Procesi i zgjerimit kthehet lart në agjendën e BE-së

SHKUP, 29 NËNTOR - Zëvendëskryetari i Qeverisë maqedonase për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, u takua me drejtorin në Drejtorinë për Zgjerim dhe Politikë Fqinjësore të BE-së, Kristijan Danielson.

Në takim u diskutua gjendja në sferën e integritetit evropian të vendit dhe perspektivat rreth kthimit të procesit të zgjerimit lartë në agjendën e BE-së, pas dështimit të ndërtimit të konsensusit në takimet e tetorit të Këshillit të IE. Ai tha se na gëzon fakti se ekzistojnë iniciativa të shumta të vendeve anëtare për

kthimin e procesit të integritetit evropian sërish lartë në agjendën e BE-së. Këtu gjithsesi është edhe iniciativa e Italisë dhe kryeministrit Conte, më pas letra e kryetarit të KE-së nga ana e 16 vendeve nënshkruese, dhe gjithsesi edhe dokumenti i Francës me të cilin konfirmohet perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor si anëtar të plotfuqishëm të BE-së. "Shpresojmë se BE-ja do ta shfrytëzojë periudhën e ardhshme për rishikim të serioz të mundësisë për caktimin e datës për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut,

gjatë kryesimit të Kroacisë, pa marr parasysh procesin e reformimit të metodologjisë për negociatave", theksoi Osmani në takim, duke shtuar se vendi mbetet i gatshëm për fillimin e negociatave, njësoj siç ishte edhe në tetor, por në përgjithësi mbetet i fokusuar në detyrimet që dalin nga harmonizimi i rregullave dhe standardeve evropiane. "Ne jemi të gatshëm për negociatave, njësoj siç ishim edhe në tetor, dhe për ne mundësia e vetme e pranueshme është anëtarësimi i plotë në Union", tha Osmani. (zhurnal).

Dy bashkëbiseduesit theksuan



optimizëm duke pasur parasysh sinjalet pozitive që arrijnë nga vendet anëtare dhe nga Brukseli për mbështetjen e procesit të

zgjerimit, duke u dakorduar se vendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është në BE.

Junckeri: I turpshëm refuzimi i negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

Presidenti në largim i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, tha se shembull më i mirë i mosmbajtjes së premtimeve është politika për zgjerimin dhe paaftësia e turpshme e liderëve evropianë për t'i mbajtur premtimet për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

BRUKSEL, 29 NËNTOR - Presidenti në largim i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, në ditën e tij të fundit në këtë post, në komentin e tij ditor të faqes politico.eu, iu kthehet dobësive dhe sukseseve gjatë mandatit të tij pesëvjeçar në krye të pushtetit ekzekutiv evropian. Për të, refuzimi i negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriore, në tetor, paraqet mosmbajtjen e premtimit ndaj këtyre dy vendeve. "Nëse fuqia e Evropës qëndron në atë që, për të qenë partnerë të besueshëm, dikush mund të na llogarisë për të mbrojtur rendin global të

themeluar në rregulla multilaterale, dobësia jonë qëndron në atë që nuk i mbajmë premtimet tona dhe ato të aleatëve tanë ndërkombëtarë", thotë Junckeri. "Shembull më i mirë është politika jonë për zgjerimin dhe paaftësia e turpshme e liderëve evropianë për t'i mbajtur premtimet për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë pasi këto qeveri përmbushën kriteret e nevojshme", thekson ai. "Respekti duhet të fitohet edhe nëse dëshirojmë ta mbajmë besueshmërinë tonë, atëherë duhet të bëjmë atë që kemi thënë se do ta



bëjmë", shkruan Junckeri në komentin e tij të lamtumirës për politico.eu. Ndërkaq, kreu i ri i Këshillit Evropian, Charles Michel, i cili të premten mori detyrën nga Donald Tusk, tha se Evropa do të bëhet më "guximtare" në skenën botërore.

Ceremonia formale e pranimit të dorëzimit u mbajt në Bruksel. "Zonja dhe zotërinj, do të jetë privilegj për mua që t'iu shërbej qytetarëve evropianë. Do t'i qasem zgjidhjes së problemeve me risi dhe efikasitet. Do ta kem mënyrën time, i hapur për dialog dhe i përkushtuar në ndër-

timin e urave dhe ndoshta më i kujdesshëm me postimet e mia në Twitter", tha Michel.

Michel, 43 vjeç, ish-kryeministër i Belgjikës, e lavdëroi Tuskun dhe, siç tha, përqendrimin e tij në ruajtjen e unitetit evropian gjatë pesë vjetëve të kaluar, derisa Evropa përballej me daljen e Britanisë nga BE-ja, me krizën me migrantë, me sulme nga xhihadistët në disa shtete të BE-së dhe me kufizime financiare.

Por, shtoi Michel, ka ardhur koha për BE-në që të ketë më shumë vetëbesim dhe të jetë më guximtare në skenën globale, veçanërisht duke ndërtuar strukturën të përbashkëta të mbrojtjes dhe sigurisë. "Ne jetojmë në paqe, por duhet të jemi vigjilentë, shumë vigjilentë", tha ai. Javën e ardhshme do ta marrë detyrën edhe Komisioni i ri Evropian, që është krahu ekzekutiv i BE-së dhe që do të udhëhiqet nga Ursula von der Leyen.

Vuçiçi: Serbia mbetet ushtarakisht neutrale

BEOGRAD, 29 NËNTOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, përsëriti të premten se Serbia do të mbetet ushtarakisht neutrale dhe se do të nënshkruajë dokumente strategjike që e konfirmojnë statusin e tillë. Vuçiçi i bëri këto komente në takim me zëvendësministrin e Jashtëm rus, Aleksandr Grushko, në Beograd. Në njoftimin për media të Presidencës së Serbisë thuhet se Vuçiçi dhe Grushko biseduan për situatën në rajon dhe se pres-

identi serb e falënderoi zyrtarin rus për "mbështetjen aktive ndaj ruajtjes së integritetit territorial të Serbisë". Vuçiçi, më 4 dhjetor, do ta takojë presidentin rus Vladimir Putin, në Soçi, për të tretën herë këtë vit. Serbia, e cila është bombarduar nga NATO-ja në vitin 1999 për shkak të dhunës në Kosovë, e kundërshton anëtarësimin në aleancë. Rusia, po ashtu, është kundër zgjerimit të NATO-s me vendet e

Ballkanit.

Këtë javë, Departamenti amerikan i Mbrojtjes ka nxjerrë një dokument, në të cilin thuhet se marrëdhëniet Serbi - Rusi janë forcuar që nga ardhja në pushtet e Vuçiçit në vitin 2012. Javën e kaluar, ndërkaq, ka dalë në pah një skandal i spiunimit të agjentëve rusë në Serbi. Edhe Kremlin, edhe Beogradi janë zotuar se nuk do të lejojnë që ky skandal t'i prishë marrëdhëniet e tyre.



KOZ-ja njofton Thaçin për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KOZ) ka njoftuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat janë mbajtur më 6 tetor. Valmir Elezi, zëdhënës i KOZ-së, ka bërë me dije se bashkë me shkresën njoftuese, KOZ-ja i ka

bashkangjitur edhe një kopje të rezultateve të certifikuara për subjektet politike dhe kandidatët pjesëmarrës në këto zgjedhje. Neni 66 i Kushtetutës së Kosovës e parasheh mënyrën e konstituimit të Kuvendit. Aty përcaktohet se Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë ditëve nga dita e

shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se ai nuk është në gjendje ta thërrasë seancën e parë, Kuvendi mbledhet pa pjesëmarrjen e presidentit. Pas konstituimit të Kuvendit, pason procedura tjetër, ajo e formimit të Qeverisë së Kosovës.



Javën e ardhshme pritet të nënshkruhet marrëveshja qeverisëse LV-LDK

Grupet punuese për harmonizimin e programit qeverisës në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë mbajtur të premtën takimin e radhës në të cilin, sipas tyre, janë pajtuar qind për qind rreth programit qeverisës, ndërsa marrëveshja për koalicionin qeverisës mund të nënshkruhet në javën e ardhshme



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë thënë të premtën se janë pajtuar për 100 për qind të programit qeverisës dhe se marrëveshja finale për koalicionin e qeverisjes pritet të nënshkruhet në fillim të javës së ardhshme nga liderët e dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa.

Albulena Haxhiu, pjesë e grupit punues të Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë, pas

takimit me zyrtarë të LDK-së, se drafti i programit qeverisës do të bëhet publik shumë shpejt. Ajo ka paralajmëruar se të shtunën do të ketë edhe një takim në mes të liderëve të këtyre subjekteve politike, derisa ka shtuar se ende nuk është diskutuar mes liderëve për temat sa i përket

pozitës së ministrit të Jashtëm, pozitës së kryetarit të Kuvendit, aq më pak për pozitën e presidentit.

Haxhiu ka bërë me dije se pozita e presidentit është përgjegjësi e liderëve.

Edhe nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka konfirmuar pajtimet

rreth programit qeverisës me LV-në.

Takimi i grupeve punuese të të dyja partive u mbajt pas takimit të së enjtes midis kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe atij të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, në përpjekje për arrit-

jen e një marrëveshjeje për bashkëqeverisje. Këto zhvillime vijnë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit, që u bë të mërkurën nga ana e KOZ-së. Në këto zgjedhje Lëvizja Vetëvendosje ka dalë partia e parë, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Përfundojnë gërmimet në Prishtinë, nuk ka mbetje mortore

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Autoritetet përgjegjëse në Kosovë i përfunduan gërmimet për një varrezë të dyshuar masive në kompleksin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kushtrim Gara, nga Komisioni për Personat e Pagjetur, konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se

gjatë tre ditësh gërmime nuk është gjetur ndonjë mbetje mortore nga lufta e fundit në Kosovë. Ai ka thënë se në këtë lokacion nuk do të ketë më gërmime. Policia e Kosovës, njësia për krime lufte, bashkë me Prokurorinë dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore i nisën gërmimet më 26 nëntor,

pas marrjes së informacioneve nga disa qytetarë, se në kompleksin e Universitetit të Prishtinës mund të ketë varrezë masive nga periudha e luftës së vitit 1999 në Kosovë.

Nga kjo luftë ende mbeten të zhdukur edhe rreth 1 600 persona.



Flet për "Epokën e re", Rrahman Rama

Ndihemi krenarë për pun

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka treguar për profesionalizmin e ushtarëve të FSK-së në operacionin e kërkim-shpëtimit pas tërmetit në Shqipëri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se gjatë këtij operacioni ata kanë treguar disiplinë, angazhim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm në punë. Për këtë ai ka thënë se ka marrë vlerësim të lartë nga autoritetet shqiptare dhe ato ndërkombëtare. Komandanti i FSK-së ka thënë se për punën e këtyre ushtarëve në këtë operacion duhet të ndihen krenarë të gjithë qytetarët e Kosovës

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË 29 NËNTOR

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka deklaruar se qytetarët e Kosovës duhet të ndihen krenarë me punën që ushtarët e FSK-së kanë bërë në Shqipëri pas tërmetit. Ai ka thënë se pjesëtarët e kësaj force në operacionin e kërkim-shpëtimit kanë treguar përkushtim dhe profesionalizëm të lartë në punë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rama ka treguar se për punën e tyre ka marrë lëvdata nga të gjithë. "Unë ndihem krenar për këtë, dhe të gjithë duhet të ndihemi krenarë për punën e FSK-së gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit pas tërmetit tragjik në Shqipëri. Për punën e tyre ne kemi marrë lëvdata edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Sigurisht se këto vlerësime më kanë bërë të ndihem i privilegjuar që jam komandant i atyre djemve dhe vajzave për punën që kanë bërë", ka thënë Rama.

Ai ka vlerësuar se paraqitja e pjesëtarëve të FSK-së në terren ka qenë e jashtëzakonshme që nga dita e parë. "Ata gjatë punës kanë treguar disiplinë, angazhim, motivim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm. Vlerësimet pozitive për punën e tyre i kemi që nga autoritetet më të larta shqiptare, duke filluar nga presidenti, kryeministri dhe ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë. Po ashtu, vlerësime të larta kemi marrë edhe prej qytetarëve shqiptarë, sepse pjesëtarët tanë detyrat i kanë kryer me përkushtim të madh dhe me profesionalizëm të lartë", ka thënë Rama.

Komandanti i FSK-së u është shprehur mirënjohës parterëve që kanë ndihmuar për ngritjen profesionale të kësaj force. "Ky nivel i lartë i forcës sonë është meritë edhe e partnerëve tanë, sidomos e partnerëve tanë strategjikë, që bashkërisht i kemi ndërtuar këto kapacitete. Pra, ne i kemi marrë prej tyre njohuritë bazë dhe më pas jemi zhvilluar edhe prej trajnimeve që kemi bërë. Në të njëjtën kohë na kanë aftësuar edhe pajisjet që kemi marrë", është shprehur ai, duke bërë me dije se deri më tani

pjesëtarët e kësaj force kanë nxjerrë nga gërmadhat katër persona. "Sa kam informacione, deri më tani janë katër persona që pjesëtarët e FSK-së i kanë nxjerrë nga rrënojat. Dy janë nxjerrë të gjallë, kurse një tjetër është nxjerrë i gjallë por, gjatë rrugës për në spital, ka ndërruar jetë. Ende nuk i dimë statistikën përfundimtare. Kur ta kemi raportin edhe nga ana e autoriteteve shqiptare, por edhe nga përgjegjësit tanë, do të mund të flasim me të dhëna të sakta", është shprehur Rama.

"Epoka e re": Z. Rama, ekipet e FSK-së kanë qenë ndër të parat që i kanë ndalë në ndihmë Shqipërisë pas tërmetit.

Rama: Pas bisedës telefonike që kanë pasur presidenti ynë me kryeministrin e Shqipërisë, të enjten e kemi dërguar një skuadër, e cila përfshinë kryesisht ekspertë që bëjnë vlerësimin e objekteve për qëndrueshmërinë e tyre, për të parë nëse janë të banueshme. Tash vetëm ka përfunduar operacioni i kërkim-shpëtimit. Tani kemi kërkesë nga autoritetet shqiptare për ndihmë të tjera, për tenda, krevat fushorë dhe pajisje të tjera përcjellëse. Brenda mundësive dhe kapaciteteve tona ne do t'u dalim në ndihmë për çfarëdo që kanë nevojë autoritetet e Shqipërisë.

"Epoka e re": Siç e kemi parë, njësitet e FSK-së në mënyrë shumë të shpejtë i janë përgjigjur ftesës së autoriteteve shqiptare për ndihmë. Sa kohë ju është dashur që ata pjesëtarë të përgatiten për këtë operacion?

Rama: Ne e bëjmë një plan vjetor, qoftë të trajnimit apo një plan operacional. Ne i vlerësojmë këto plane dhe në zhargonin ushtarak është analiza e pasveprimeve dhe mësimet e mësuara. Normalisht se aty ku mund të ketë mangësi apo dobësi ne koncentrohemi për t'i eliminuar ato mangësi me anë të trajnimeve. Prej marrjes së informatës neve na janë dashur rreth tri orë që njësitë tona ta marrin rrugën për në Shqipëri dhe brenda pesë orëve kemi qenë në operacion. Ne kemi edhe ligjin për dislokimin e forcave jashtë vendit dhe është dashur që në këtë drejtim të respektohen të

gjitha procedurat.

"Epoka e re": Gjatë kësaj kohe, sa ushtarë të FSK-së kanë shkuar për ta ndihmuar Shqipërinë?

Rama: Ne kemi pasur 60 pjesëtarë atje. Sigurisht se të enjten në mbrëmje një pjesë e tyre kanë kryer operacionin dhe janë kthyer në Kosovë, kurse pjesa tjetër janë nën urdhrat e ushtrisë shqiptare. Operacioni i kërkim-shpëtimit në Thumanë ka përfunduar dhe më nuk ka punë për njësitet e specializuara të kërkim-shpëtimit. Tani vijnë në shprehje nevojat e tjera dhe do t'ju njoftojmë për çdo veprim tonin. Tani në Shqipëri banorët kanë nevojë për strehim, tenda, batanije dhe krevat fushorë.

"Epoka e re": Ju i keni vizituar pjesëtarët e FSK-së në këtë operacion të kërkim-shpëtimit. Keni marrë ndonjë vlerësim nga të tjerët për punën e tyre?

Rama: Paraqitja e pjesëtarëve tanë që nga dita e parë e jashtëzakonshme. Ata gjatë punës kanë treguar disiplinë, angazhim, motivim dhe profesionalizëm të jashtëzakonshëm. Vlerësime pozitive për punën e tyre kemi marrë nga autoritetet më të larta shqiptare, duke filluar nga presidenti, kryeministri dhe ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë. Po ashtu, vlerësime të larta kemi marrë edhe prej qytetarëve shqiptarë, sepse pjesëtarët tanë detyrat i kanë kryer me përkushtim të madh dhe me profesionalizëm të lartë.

"Epoka e re": Si e keni ndier veten si komandant i kësaj force kur keni marrë vlerësime pozitive për ushtarët tuaj?

Rama: Unë ndihem krenar për ta dhe të gjithë duhet të ndihemi krenarë për punën e FSK-së gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit pas tërmetit tragjik në Shqipëri. Për punën e tyre ne kemi marrë lëvdata edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Sigurisht se këto vlerësime më kanë bërë të ndihem i privilegjuar që jam komandant i atyre djemve dhe vajzave për punën që kanë bërë. Ky nivel i lartë i forcës sonë është meritë edhe partnerëve tanë, sidomos partnerëve tanë strategjikë që bashkërisht i kemi ndërtuar këto kapacitete. Pra, i kemi marrë prej tyre njohuritë bazë dhe më pas



jemi zhvilluar edhe prej trajnimeve që kemi bërë. Në të njëjtën kohë na kanë aftësuar edhe pajisjet që kemi marrë, sidomos për njësinë e geneve, por edhe pajisjet e tjera specialistike që na kanë mundësuar ta kryejmë operacionin në mënyrën më të mirë të mundshme.

"Epoka e re": A keni ndonjë statistikë se sa persona kanë nxjerrë nga gërmadhat ushtarë të FSK-së?

Rama: Sa kam informacione, deri më tani janë katër persona që pjesëtarët e FSK-së i kanë nxjerrë nga rrënojat. Dy janë nxjerrë të gjallë, kurse një tjetër

ën e FSK-së në Shqipëri



është nxjerrë i gjallë por, gjatë rrugës për në spital, ka ndërruar jetë. Ende nuk i dimë statistikat përfundimtare. Kur ta kemi raportin edhe nga ana e autoriteteve shqiptare, por edhe nga përgjegjësit tanë, do të mund të flasim për të dhëna të sakta.

"Epoka e re": Ushtarët e FSK-së kanë operuar edhe me forcat e vendeve të tjera. Si ka qenë bashkëpunimi me këto forca gjatë këtij operacioni?

Rama: Ajo që duhet të theksoj është se gjatë vizitës në terren që kemi pasur me presidentin e Kosovës, ekipet tona kanë

bashkëpunuar dhe operuar bashkërisht me vendet e tjera partnere. Për shembull, në Thumanë kanë operuar me njësitet e specializuara nga Greqia, kurse në Durrës kanë operuar me ekipet e specializuara nga Rumania dhe nga vendet e tjera.

Stafi i UP-së ofron ndihmë pas situatës së krijuar në Shqipëri

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Me qëllim të realizimit të ndihmës, pas situatës së krijuar në Republikën e Shqipërisë për shkak të tërmetit të ndodhur, si dhe të bazuar në komunikatën e lëshuar nga Rektorati i UP-së për ofrimin e të gjitha kapaciteteve për ndihmë, disa nga mësimitdhënësit e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Fakultetit të Arkitekturës kanë realizuar të enjten një vizitë pune në Durrës, me ç'rast aktivisht janë përfshirë në vlerësimin e dëmtimeve në çastet e para pas tërmetit. Aktiviteti i angazhimit të mësimitdhënëseve nga UP-ja në këtë fazë ka qenë në koordinim me menaxhmentin e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Tiranë. Koordinimi është realizuar nga zëvendësdekani i Fakultetit në Tiranë, prof. dr. Agim Serenaj dhe përfaqësuesja e Bashkësisë së Durrësit, Davida Ndoj.

Gjatë këtij aktiviteti janë vizituar 30 objekte të banimit në Lagjen nr. 18 - Keneta, ku për objektet e vizituara janë përgatitur raportet e vlerësimit, që pastaj ato raporte janë përcjellë në Qendrën e Emergjencave Civile në Durrës.

Mësimitdhënësit u pajtuan që hapat në vijim do të realizohen konform kërkesave dhe nevojave të parashtruara.

Mësimitdhënësit e Fakultetit të Ndërtimtarisë shprehën gatishmërinë që të jenë në dispozicion, duke përfshirë edhe mësimitdhënësit të tjerë që me komisione të përbashkëta me mësimitdhënësit nga Universiteti Politeknik i Tiranës të angazhohen për vlerësime profesionale të objekteve ndërtimore të dëmtuara.

Në anën tjetër, ndihmë ofroi edhe Departamenti i Psikologjisë, profesorët e të cilit kanë realizuar një trajnim intensiv njëditor, me qëllim të përgatitjes së psikologëve për ofrim të mbështetjes psiko-sociale dhe këshillimit për të gjithë personat e zhvendosur nga Shqipëria në ish-kampin e KFOR-it.

Profesorët dhe studentët do të luajnë një rol aktiv në procesin e ofrimit vullnetar të mbështetjes psiko-sociale dhe këshillimit. Ata do të ofrojnë mbikëqyrje dhe trajnim të vazhdueshëm profesional për ekipet mobile të studentëve dhe profesionistëve të shëndetit mendor të Prizrenit, që do të ofrojnë shërbime në terren.





RRITET NUMRI I VIKTIMAVE NGA TËRMETI NË SHQIPËRI, MBI 1 200 BANESA TË DËMTUARA

Së paku 49 persona kanë vdekur dhe qindra të tjerë janë lënduar nga tërmetet që goditën Shqipërinë që prej orëve të para të mëngjesit të së martës. Tërmeti i 26 nëntorit me magnitudë 6.4 ballësh të Rihterit ishte më i fuqishmi që ka goditur Shqipërinë që disa dekada. Epiqendra e tij ishte në Detin Adriatik, rreth 30 kilometra në veriperëndim të Tiranës. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë mbledhjes së kabinetit qeveritar ka thënë se 25 viktima janë në Durrës, 23 në Thumanë dhe një në Laç. Po ashtu, ka thënë se janë mbi 1 200 banesa të dëmtuara

nistrin Edi Rama, në zonën e Durrësit janë 701 banesa të dëmtuara, 12 të shkatërruara totalisht dhe 176 pallate të dëmtuara. Ndërsa në Tiranë, 15 banesa janë të shkatërruara dhe 239 të dëmtuara, ndërsa tetë pallate janë jashtë funksionit dhe 61 të dëmtuara. Mbi 5 200 qytetarë janë të pastrehë, nga të cilët 3 480 në rajonin e Tiranës dhe 1 760 në Durrës dhe Thumanë. Kryeministri Rama ka thënë se tentat do të mbyllën dhe të gjithë personat e pastrehë do të sistemohen pranë struktu-

rave hoteliere me të cilat qeveria ka bërë marrëveshje.

Dy ditë më parë Qeveria e Shqipërisë shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Tiranë dhe Durrës. Të premtën në listë u përfshi edhe Laçi për shkak të dëmeve të mëdha të regjistruara edhe në këtë zonë.

Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë ka njoftuar se numri i personave të lënduar nga tërmeti është së paku 790 që kanë marrë trajtim në spitale, nga të cilët 700 vetëm në spitalin e Traumës dhe Durrësit. Ekipet e shpëtimit nga

më shumë se 10 shtete u janë bashkuar ekipeve në Shqipëri, më 27 nëntor, për t'i kërkuar personat që mund të kenë mbetur nën rrënoja.

ShBA-ja mbështet ndihmën humanitare në Shqipëri

Ambasada e ShBA-së në Tiranë përmes një postimi në rrjetet sociale ka pohuar se Qeveria e Shteteve të Bashkuara po vazhdon të mbështesë me ndihma humanitare në Shqipëri. "USAID-i po bashkëpunon me Kryqin e Kuq Shqiptar për të siguruar rezerva emergjence për njerëzit e prekur nga tërmeti. Me financim të USAID-it, Kryqi i Kuq po shpërndan artikuj jetikë humanitarë, si batanije dhe paketa higjienike, në vendet e prekura më shumë. Zyra për Ndhimë të Jashtme në raste fatkeqësish e USAID-it ka sjellë edhe një ekspert fatkeqësish natyrorë në Shqipëri, për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave prioritare për ndihmë humanitare", thuhet në njoftimin e ambasadës. →

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

TIRANË, 29 NËNTOR - Në Shqipëri ka rritur në 49 numri i viktimitave të tërmetit të fuqishëm që goditi vendin të martën, ndërsa operacionet e kërkimshpëtimit po shkojnë drejt fundit dhe paraditen e së premtes po kërkohet vetëm nën rrënojat e një hoteli në Durrës, ku dyshohet të jetë ende trupi i një personi. Gjatë së premtes në Thumanë është bërë varrimi i 11 personave që humbën jetën si pasojë e tërmeteve që goditën Shqipërinë. Është pikërisht Durrësi qyteti me

numrin më të madh të personave që kanë humbur jetën, 25 viktima. Goditjet e tërmetit shkatërruan duke rrënuar plotësisht, dy hotele në zonën e plazhit, dy pallate në qytet si dhe një banesë trekatëshe në zonën e ish-Kënetës. Ndërsa në Thumanë, ku kërkimet u konsideruan të mbyllura të enjten, ishin 23 persona që humbën jetën nën rrënojat e dy pallateve të rrënuar.

Të premtën qeveria shqiptare ka njoftuar edhe për një bilanc të parë të dëmeve, ku janë mbi 1 200 banesa dhe pallate të prekur nga tërmeti. Sipas kryemi-



Erdogani: Do t'i ndërtojmë 500 banesa për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri

Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka bërë me dije se shteti turk do t'i ndërtojë 500 banesa për banorët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri. "Shpresojmë që ekipet tona do t'i kryejnë punimet në vendet e përshtatshme në Shqipëri dhe si vëllëzër turk do të ndërtojë 500 njësi banimi", ka thënë Erdogan, raporton "Anadolu Agency". Edhe biznesmeni Samir Mane ka dhuruar të premtën 1.2 milion euro për të dëmtuarit nga tërmeti.

Ambasadori i Kosovës në Tiranë: Mund të dërgojmë qytetarë edhe në spitalet e Prishtinës

Ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Nait Hasani, ka thënë se Shqipëria tani ka nevojë për psikologë dhe trajtime mjekësore, për personat e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit. Ai ka thënë se qytetarët janë traumatizuar dhe kanë nevojë të trajtohen, gjithashtu ka nevojë për ekupe që bëjnë vlerësimin e objekteve, në mënyrë që të dihet se cilat janë të qëndrueshme për banim. "Këtu kemi nevojë për mjekë. Do të thotë, duhen psikologë sepse njerëzit kanë panik. Këta njerëz kemi mundësi t'i dërgojmë edhe në spitale të ndryshme në Kosovë", ka thënë Hasani.

FSK-ja e ndihmon Shqipërinë me pajisje për strehim

Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe me urdhër të komandantit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, FSK-ja të premtën ka nisur kontingjentin e parë me pajisje ushtarake fushore për Shqipëri. Për shkak të katastrofës nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë, një numër i madh i familjeve kanë mbetur pa kulm mbi kokë dhe, në bazë të vlerësimeve të para të bëra nga ekspertët, shumë shtëpi nuk janë të sigurta për banim.



Kontingjenti i FSK-së, i cili do të mbërrijë gjatë ditës, përmban: tenda, shtretër fushorë, batanije dhe pajisje të tjera përcjellëse të cilat do të dorëzohen në Shtabin e Krizës në Republikën e Shqipërisë.

Kurti viziton Durrësin dhe Thumanën

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga bashkëpartiakët, ka vizituar të premtën zonat e goditura nga tërmeti, Durrësin dhe Thumanën. Ai ka thënë se populli i Shqipërisë dhe ai i Kosovës, si dhe shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi, Luginës së diasporës, të gjithë janë bërë bashkë për t'ua lehtësuar dhimbjen familjarëve të atyre që fatkeqësisht kanë humbur jetën prej tërmetit, por edhe atyre qindra personave të lënduar e të traumatizuar e shumë të tjerëve që janë dëmtuar ekonomikisht, një pjesë e mirë duke mbetur edhe të pastrehë. Kurti ka vizituar shkollën "Leonik Tomeu" në Durrës, njërin nga

vendet ku magazinohen ndihmat e dhuruara nga qytetarë të Shqipërisë e të Kosovës. "Në stadiumin 'Niko Dovana' u takuam me pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, ndër ta edhe me kolonelin nga Shqipëria, Arben Toska dhe koordinatoren e FSK-së për veprimet në Shqipëri, Nysret Buzhala, e komandantin e Njësitit të Kërkim/Shpëtimit, Kreshnik Limoni. Është për t'u përgëzuar angazhimi i tyre i përbashkët dhe harmonia organizative e disiplinën me të cilën ushtria iu qaset këtyre rasteve emergjente. Forcimi i ushtrive të Shqipërisë e të Kosovës do të duhet të ishte prioritet për qeveritë tona, sepse kjo do të ndihmonte përballimin e situatave të tilla, të cilat vijnë papritur", ka thënë Kurti. Ai më pas ka vizituar edhe Thumanën, ku ka biseduar me familjarë të viktimave, me banorë të qytezës, me vullnetarë të cilët punonin në kampin e tendave, por edhe me politikanë që kishin shkuar për vizitë aty.



Haradinaj në Durrës: Kosova nuk do të kursejë asgjë për t'i dalë në ndihmë Shqipërisë

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, ministrat Rrustem Berisha, Abelard Tahiri e Pal Lekaj, të premtën ka udhëtuar për në Shqipëri, për t'i parë nga afër zonat e prekura nga tërmeti dhe për ta shprehur gatishmërinë e institucioneve të Kosovës dhe gjithë popullit të saj, se do të jenë pranë të gjithë qytetarëve të prekur nga kjo tragjedi. Haradinaj ndalesën e parë e ka bërë te njësitet e FSK-së, Policisë së Kosovës dhe ekipet e Emergjencës nga Kosova, të cilët i ka falënderuar për angazhimin dhe për kujdesin e tyre për t'u dalë në ndihmë të prekurve nga kjo fatkeqësi natyrore. Ai ka thënë se ndihet i nderuar që me një pjesë të kabinetit qeveritar, në shoqërim të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, janë sot në Durrës për t'u dhënë përkrahje të mëtejme të gjithë të angazhuarve për përballimin e gjendjes. "Ne bashkëndiejmë me familjet për viktimat dhe me të gjitha ato vështirësi që i ka Shqipëria. Do të vazhdojmë të jemi bashkë", u shpreh kryeministri në detyrë, Haradinaj, duke theksuar se Kosova i ka në dispozicion të gjithë mekanizmat. Kryeministri Haradinaj i siguroi të gjithë se Kosova nuk do të kursejë asgjë në këtë aspekt dhe tregoi se ka një numër të caktuar të qytetarëve të Shqipërisë që janë në Kosovë, disa në familje private e hotele, e rreth 500 prej tyre tashmë janë vendosur në

Parkun Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman në Prizren. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka falënderuar për të disatën herë shtetin e Kosovës, popullin e saj, institucionet, Qeverinë e Kosovës, kryeministrin Haradinaj, zëvendëskryeministrin Hoxhaj, ministrat dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë, në mënyrë të veçantë Forcën e Sigurisë së Kosovës që, siç ka thënë ai, kanë shkëlqyer me reagimin e menjëhershëm që në orët e para të përballimit të kësaj tragjedie dhe vazhdojnë të bëjnë më të mirën përkrah forcave të tyre dhe në ndihmë të qytetarëve që kanë vuajtur këto pasoja të tmerrshme. "Ky solidaritet e ka bërë më të lehtë përballimin e këtyre pasojave të kësaj dhimbje. Për këtë z. kryeministër duhet të jeni krenar për Forcën e Sigurisë së Kosovës, policinë, sepse jam i sigurt që çdo vend i NATO-s do të ishte krenar për më të mirën që ata e kanë shfaqur gjatë këtyre dy-tri ditëve dhe netëve pa ndalim dhe pa u lodhur", u shpreh presidenti Meta i cili, po ashtu, i falënderoi kryeministrin Haradinaj dhe Qeverinë për ndarjen e 500 mijë eurove për Shqipërinë. Kryeministri në detyrë, Haradinaj, më pas ka vizituar disa nga zonat më të prekura nga ky tërmet, duke shprehur solidaritetin e popullit dhe të Qeverisë së Kosovës për familjet që kanë humbur më të dashurit e tyre, por edhe për gjithë ata që janë prekur nga kjo fatkeqësi.



Vajza 9-vjeçare nga Shtimja jep për Shqipërinë dhuratën e vet më të çmueshme, kukullën

Nëntëvjeçarja Zerina Jakupi, nxënëse e klasës së IV ShFMU "Emin Duraku" në Shtime, është solidarizuar me tërmetin që goditi Shqipërinë, ku mbetën të vdekur dhjetëra persona dhe mbi 700 të tjerë u lënduan.

Zerina ka dhënë dhuratën e vet të çmueshme për Shqipërinë, një kukull. Pra, dikush jep pensionin, dikush mëditjen, dikush stre-

himin, kushdo jep diçka nga mundësia dhe zemra. Zerina ka vendosur ta japë kukullën e saj për ndonjë shoqe të mërzitur për lodrat e humbura në tërmetin e kobshëm të 26 nëntorit.

Fotografia e Zerines, e cila është publikuar nga e ëma, Kimete Hoxha, në rrjetin social "Facebook", publikohet në versionin online të "Epokës së re", me lejen e prindërve.



Mbi 500 qytetarë nga Shqipëria sistemohen në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren



PRIZREN, 29 NËNTOR (ER) - Në qytetin e Prizrenit është mbledhur të premtën ekipi emergjent që po angazhohet për strehimin dhe kujdesin e personave të prekur nga tërmeti në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve për ta analizuar gjendjen dhe shikuar hapat e më tutjeshme që duhet t'i bëjmë për ta menaxhuar këtë gjendje të jashtëzakonshme. Fluksi i të ardhurve nga Shqipëria të enjten ka qenë shumë i madh, me ç'rast Parku i ka përmbushur të gjitha

kapacitetet që ka në dispozicion, duke i sistemuar mbi 500 persona. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka kërkuar nga të gjithë të kenë parasysh këtë dhe mos të drejtohen te Parku pa paralajmërim, pasi nuk ka më kapacitet të pranohen më shumë persona.

Ai ka bërë me dije se të gjithë të ardhurit në Park janë regjistruar, ndërsa tani e tutje do të bëjnë edhe një regjistër për të mësuar për nevojat e tyre. "Nga Shërbimi Pedagogjik-Psikologjik,

që është në kuadër të komunës sonë, nga sot do të angazhohet një ekip i specializuar për t'u kujdesur edhe për gjendjen psikologjike të tyre, derisa ekipet e kujdesit shëndetësor primar kanë qenë të angazhuar që nga fillimi dhe kanë kryer një punë të shkëlqyer deri më tani. Të enjten dhe sot ushqimi është siguruar nëpërmjet donacioneve që kanë ardhur nga bizneset lokale, mirëpo kjo nuk mund të vazhdojë kështu edhe më tej dhe për këtë arsye po shikojmë mundësinë që

urgjentisht të krijojmë një kuzhinë mobile dhe ta sigurojmë ushqimin në bashkëpunim me shoqatat bamirëse", ka thënë ai.

Përveç sistemimit të personave në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve, Haskuka ka thënë se edhe shumë familje i kanë hapur shtëpitë e tyre vullnetarisht për t'i pranuar personat e prekur nga tërmeti. "Për këtë, lus të gjithë ata që i kanë pranuar miqtë tanë nga Shqipëria apo kanë vende të lira dhe mund të pranojnë persona të

tjerë, le të lajmërohen në Qendrën e Thirrjeve 'Alo Komuna' në numrat 0800 19 200 dhe në Viber +383 45 119 200, në mënyrë që ta bëjmë identifikimin e tyre dhe të kemi një databazë për ta pasur më të lehtë menaxhimin e kësaj situatë. Kjo do të na mundësonte që të gjejmë zgjidhje më të lehtë ndaj atyre personave që vijnë e nuk kanë ku të strehohen, njëkohësisht të ofrojmë shërbime shëndetësore dhe arsimore ndaj tyre", ka thënë Haskuka.

Dy aktakuza për rastin e veteranëve



FERIZAJ, 29 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur dy aktakuza kundër dy personave të pandehur për shkak të veprës penale "Legalizimi i përmbytjes së rreme" nga neni 403, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Prokuroria njofton se të pandehurit R. A. dhe N. A. nga Ferizaj gjatë muajit prill 2018 kanë vënë në lajthim organin kompetent - Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ta vërtetuar një çështje të pavërtetë, kinse dy

të pandehurit janë "Veteran Luftëtar të UÇK-së", në atë mënyrë që me dokumente të falsifikuara, edhe certifikatën "Veteran Luftëtar" dhe vërtetimin e veteranit luftëtar, të pandehurit kanë aplikuar në skemën e pensioneve dhe përfitimeve të familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe kategorive të tjera të përcaktuara me ligj, ku kanë arritur të përfitojnë pagë mujore prej 170.00 eurove secili veç e veç, nga muaji maj 2018 deri në muajin shtator 2018, duke i shkaktuar dëme

materiale të dëmtuarës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në shumën prej 1 020.00 eurosh secili veç e veç.

Me këto veprime të pandehurit R. A. dhe N. A. kanë kryer veprën penale "Legalizimi i përmbytjes së rreme" nga neni 403, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Ministri Bytyqi takohet me homologun maqedonas

SHKUP, 29 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, është takuar të premtën në Shkup me ministrin e Arsimit të Maqedonisë

Vëriore, Arbër Ademi, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit në arsim mes dy vendeve. Të dy ministrat u pajtuan se edhe bashkëpunimi i deritanishëm në mes të

Kosovës dhe Maqedonisë në arsim ka qenë i shkëlqyeshëm, por theksuan se ka hapësirë për bashkëpunim edhe më të madh në të gjitha nivelet e arsimit. Gjatë këtij takimi

ministrat Bytyqi dhe Ademi vunë theksin tek arsimit i lartë, ku bashkëpunimi mund të ndikojë në ngritjen e cilësisë, që është edhe qëllim i të dy shteteve.



BPB-ja merr çmimin 'The Banker'

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Banka për Biznes (BPB) ka njoftuar se për të dytën herë me radhë ka arritur të shpërblehet me çmimin "The Banker" si banka më e mirë e vitit në Kosovë për vitin 2019 nga gazeta prestigjioze "Financial Times", e cila e bën vlerësimin e sektorit global financiar që nga viti 1926.

Arton Celina, drejtor ekzekutiv i Bankës për Biznes, ka marrë çmimin e vlefshëm dhënë BPB-së për Kosovë në ceremoninë e madhe të ndarjes së çmimeve në Londër nga "The Banker". "Sot të gjithë ne në BPB jemi shumë krenarë dhe të nderuar me çmimin e pranuar si banka më e mirë e vitit në Kosovë. Ky besim dhe vlerësim i gjithëmbarshtëm që i po i jepet në vazhdimësi BPB-së reflekton

mbi përpjekjet tona për ta vënë në funksion strategjinë e bankës për ta transformuar ekonominë e vendit përmes mbështetjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm që ne ua bëjmë bizneseve të vogla dhe të mesme dhe sektorit agrar në Kosovë", ka deklaruar drejtori ekzekutiv i BPB-së, Arton Celina.

Sipas tij, çmimi për BPB ka ardhur si rezultat i sukseseve të bankës për lehtësimin e kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që njihen si katalizatori kryesor i zhvillimit të ekonomisë së një shteti. "Përmes pozicionimit strategjik dhe qasjes së lehtë dhe fleksibile ndaj klientëve dhe konsumatorëve të saj, BPB tani ka marrë 15 për qind të tregut në këtë sektor. Nga përvoja jonë me klientët jo-bankarë kemi konstatuar se ndërmarrjet e reja, gratë sipërmarrëse dhe të



rinjtë që kanë ide të reja për biznes, përballen me qasje tejet të kufizuar në financa dhe kjo është pengesa kryesore për rritjen e tyre. Për ta evituar këtë pengesë në treg dhe me qëllim të mbështetjes së këtij segmenti të përjashtuar nga tregu, BPB-ja ka zhvilluar programin 'Përfshirja financiare', e cila është nismë që synon të sigurojë qasje në pro-

dukte financiare të dobishme dhe të përballueshme me produkte dhe shërbime të cilat ofrohen në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme", u shpreh Celina, duke shtuar se disponueshmëria e shërbimeve financiare që plotësojnë nevojat specifike të përdoruesve pa asnjë diskriminim është qëllimi kyç i bankës së tyre.

"Iniciativa e BPB-së, e vlerësuar nga tregu vendor, posaçërisht nga 'The Banker', përveç qasjes në financa, ka edhe përfitime sociale pasi promovon barazinë gjinore, ulë papunësinë, bën rregullim shumë të nevojshëm të bilancit tregtar dhe ndikon pozitivisht në produktivitetin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë", ka thënë më tutje Celina.

Vlerësimet e 'The Banker' sigurojnë inteligjencë ekonomike dhe financiare për sektorin financiar në botë dhe institucionin ka krijuar reputacion për raportim objektiv dhe të saktë të këtij sektori në mbarë botën.

Ngjarja ceremoniale e ndarjes së çmimeve nga "The Banker" është mbajtur më 29 nëntor në Londër. Kjo është hera e dytë që BPB fiton çmimin prestigjioz si banka më e mirë e vitit në Kosovë nga "The Banker".

Zyra e Grupit të BB-së shënoi 20-vjetorin e partneritetit me Kosovën



PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Zyra e Grupit të Bankës Botërore (BB) në Kosovë ka shënuar 20-vjetorin e partneritetit me Kosovën dhe 10-vjetorin e anëtarësimit të Kosovës në institucionet e Grupit të BB-së me një pritje për zyrtarë të institucioneve, përfaqësues politikë, aktivistë të shoqërisë civile, përfaqësues të odave tregtare dhe të sektorit privat.

Në këtë aktivitet mysafirëve u janë drejtuar me një fjalë rasti zëvendës-presidenti i Bankës Botërore për Evropë dhe Azi Qendrore, Cyril Muller, drejtoresha e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder, drejtori i IFC-së për Evropën Qendrore dhe Juglindore, Thomas Lubeck, si dhe ministri në detyrë i Financave të Kosovës, Bedri Hamza. Me këtë rast, zëvendës-presidenti Muller ka thënë se partneriteti me Kosovën ka bërë një rrugë të gjatë. "Nga rindërtimi dhe normalizimi i jetës pas konfliktit, ne

sot po i ndihmojmë Kosovës të kalojë në një rritje më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ne synojmë ta mbështesim këtë qëllim duke e fokusuar mbështetjen tonë në tri fusha në veçanti: përshtetimin e rritjes së sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe promovimin e energjisë së besueshme. Mund të jemi krenarë me rezultatet që i kemi arritur së bashku dhe shumë prej jush kanë luajtur rol kyç. Jemi entuziastë për thellimin e partneritetit me autoritetet e reja, që t'i ndihmojmë Kosovës t'i arrijë qëllimet e veta zhvillimore", ka thënë Mulleri. Kosova është bërë anëtare e Grupit të Bankës Botërore në qershor të vitit 2009 dhe deri më sot BB-ja ka siguruar rreth 500 milionë dollarë në grante dhe kredi, duke investuar në njerëzit dhe ekonominë e Kosovës.

Oda Amerikane dhe Gjirafa.com nisin kontingjentin e parë të ndihmave drejt Shqipërisë

PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Katër maune me artikuj ushqimorë, veshmbathje dhe artikuj të tjerë elementarë janë nisur nga Oda Ekonomike Amerikane dhe kompania "Gjirafa.com" drejt Shqipërisë si shenjë solidarizimi me banorët e Shqipërisë të prekur nga tërmeti i fundit tragjik. Vlera e të gjitha mallrave të dhuruara deri më tani arrin vlerën e rreth 40 000 eurove. Ndërsa falë kontributit të bizneseve, qytetarëve, Odës Amerikane, si dhe stafit të

Gjirafa.com janë mbledhur edhe të holla në vlerë prej 12 150 eurosh. Kontribut monetar kanë dhënë kompanitë "KEP Trust", "KIVO", "Delfin LTD", "Asseco", "Klinika Amerikane", "AS Travel", "Melita & Partners", "Indeson WBC", si dhe qytetarët Burim Cena, Xhevat Dedinca dhe Fiknete Balaj. Kontributit me të holla i janë bashkuar edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, si dhe stafi i kompanisë Gjirafa.com dhe klientët e tyre. Kompanitë që kanë

kontribuar me produkte ushqimore dhe pije, veshmbathje, enë si dhe artikuj higjienikë përfshijnë: "Delfini LTD", rrjeti i supermarketeve "Interex", "Buçaj", "Al Trade Center", "Pestova", "Albatros", "Auto Servis Fatosi", "Frutti", "Furra e bukës "Sheki", "Keranova" dhe "Luga". Oda Ekonomike Amerikane si dhe Gjirafa.com do të vazhdojnë të mbledhin ndihma për banorët dhe zonat e prekura nga tërmeti në Shqipëri edhe në ditët në vijim.



Prishtinës i shtohet edhe një kënd 'Te Pema'



PRISHTINË, 29 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kryeqytetit të Kosovës të premtën i është shtuar edhe një kënd "Te Pema". Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky kënd është vendosur në sheshin "Skënderbeu". "Edhe një kënd 'Te Pema' i është shtuar Prishtinës dhe është vendosur në sheshin 'Skënderbeu'. 10 këndet 'Te Pema', të vendosura në Prishtinë, janë rezultat i bashkëpunimit të Komunës së Prishtinës me ICK - Innovation Centre Kosovo dhe janë pjesë e

inkubatorit të Innovation Centre Kosova. Ky produkt ka për qëllim vetëdijesimin për rëndësinë e ajrit të pastër për shëndetin tonë dhe përmirësimin e cilësisë së tij nëpër zonat urbane, ku ndotja është më e madhe", ka shkruar Ahmeti.

"Te Pema" është i mbushur me bimë që kanë aftësi shumë të mëdha të filtrimit të ajrit dhe prodhimit të oksigjenit. Kjo është bërë e mundur falë renditjes, pozitës dhe sistemit automatik të ujitjes i cili bën që bimët ta filtrojnë ajrin me kapacitet maksimal.

Komuna e Malishevës bën ndryshime në disa udhëzime administrative

Malishevë, 29 nëntor (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Malishevës, Bashkim Krasniqi, ka njoftuar se janë miratuar disa udhëzime administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Me këto udhëzime janë bërë disa ndryshime sa i përket Zyrave Kadastrale Komunale.

Ai ka thënë se si rrjedhojë e kësaj kërkesat për matje, ndarje, bashkim parcelash, për kufijtë e parcelave dhe rregullim të kufijve më nuk mund të bëhen në

Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë. "Pra, këto kërkesa kanë kaluar në kompetencën e kompanive gjeodeze, gjeodetët e licencuar dhe teknikë të gjeodezisë të licencuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Pra, gjeodetët që janë të punësuar si zyrtarë në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë mund të kryejnë punë terreni vetëm në interes të komunës dhe kërkesave në interes publik. Këto udhëzime kanë hyrë në fuqi dhe janë të detyrueshme të zbatohen menjëherë", citohet të këtë thënë Krasniqi.



Dështon seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Gjilanit, shkak mungesa e kuorumit



GJILAN, 29 NËNTOR (ER) - Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Gjilanit, e thirrur me iniciativë të 15 asamblistëve të PDK-së, Vetëvendosjes, Vatrës dhe këshilltarëve të pavarur, për të diskutuar për lokacionin e ri të varrezave të qytetit, i cili është planifikuar të jetë në pjesën e Zabelit, ka dështuar të mbahet për mungesë të kuorumit.

Kryesuesja Shpresa Kurteshi-Emini, pas konstatimit nga sekretaria e Kuvendit, se në sallë janë të

pranishëm 16 asamblistë dhe mungojnë 19 prej tyre, ka konstatuar se seanca nuk mund mbahet për shkak të mungesës së kuorumit.

Ndërsa Sadri Arifi, shef i Shërbimit të Kuvendit, ka sqaruar se, sipas statutit të Komunës së Gjilanit dhe Ligjit për qeverisje lokale, për të pasur kuorumin e nevojshëm duhet të jenë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve të Kuvendit.

Në anën tjetër, Riza Abdyli nga PDK-ja ka reaguar ndaj kësaj situ-

ate, duke thënë se kjo seancë duhet të mbahet patjetër pasi nuk mund të shtyhet në pakufi. Në sallë ishin të pranishëm nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, si dhe drejtorët komunalë.

Pas kësaj opozita ka mbajtur konferencë me gazetarë duke thënë se do të insistojnë që kjo seancë të mbahet patjetër në ditët e ardhshme pasi, sipas tyre, bëhet fjalë për një çështje shumë të rëndësishme, siç është lokacioni për varreza.

Komuna e Kaçanikut ndan 10 000 euro për Shqipërinë e prekur nga tërmeti

KAÇANIK, 29 NËNTOR (ER) - Me një minutë heshtje ka filluar punimet mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019, në nderim të viktimave që kanë humbur jetën nga fatkeqësia natyrore në Shqipëri. Në këtë mbledhje, pas propozimit të asamblistëve të Vetëvendosjes, në mënyrë unanime janë ndarë 10 000 euro si mbështetje për Shqipërinë.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka shprehur ngushëllime për familjet që kanë humbur më të dashurit e tyre nga kjo fatkeqësi natyrore. Ai ka falën-

deruar qytetarët e Kaçanikut të cilët në mënyrë masive i janë përgjigjur aksionit vullnetar për dhurimin e ndihmave në formë të ndryshme për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri.

Kryetari Ilazi ka thënë se për shkak të specifikave të fundvitit që paraqiten në realizim të buxhetit, Komuna e Kaçanikut planifikon të ndajë 10 000 euro nga buxheti i saj në ndihmë Shqipërisë. Ky propozim është përkrahur nga të gjithë anëtarët e Kuvendit, të cilët kanë ngushëlluar familjet e viktimave si dhe kanë uruar që Shqipëria sa më shpejt të rimëkëmbet.



SA ËSHTË E RREZIKUAR KOSOVA NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Fatkeqësitë natyrore janë të paparashikueshme, me intensitete dhe efekte të ndryshme, të cilat mund të godasin në çdo çast, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të jetëve të njerëzve dhe të mirave materiale.



Shkruan: TAHIR AHMETI

Me fatkeqësi natyrore kuptohen tërmetet, përmytjet, thatësi të atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore, ndërsa me fatkeqësi të tjera kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret,

shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.

Nga hulumtimet dhe analizat e ndryshme të bëra, por edhe duke u bazuar në raportet e publikuara nga institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, Kosova kryesisht rrezikohet nga tri rreziqe natyrore: tërmetet, vërshimet dhe zjarret e pyjeve. Mirëpo, edhe rreziqet e tjera nuk duhet të nënvlerësohen si: reshjet e mëdha të borës, ortekët, erërat e forta, rrëshqitjet e dheut dhe dëmtimet e pendëve të liqeneve artificiale, gjithashtu rreziqe mund të vijnë edhe nga faktori njeri, si: sulmet e supozuara terroriste, aksiden-

tet ajrore, hekurudhore, rrugore dhe rrjedhjet e mundshme të materieve kimike dhe naftës. Institucionet e Republikës së Kosovës kanë miratuar Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, që ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe kanë hartuar dokumentet bazë siç është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave dhe Plani i Reagimit Kombëtar. Në bazë të këtij ligji, shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si sistem unik dhe integral shtetëror.

Reaguesit e parë në situata të këtyre fatkeqësive janë zjarrfikësit, shërbimet mjekësore emergjente dhe policia ndërsa, sipas ligjit, në rast të fatkeqësive fillimisht nivelet lokale (komunat) janë përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, por nëse ato nuk mund ta menaxhojnë situatën e bëjnë kërkesën në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, e më pas Agjencia në bazë të rrethanave të krijuara kërkon angazhimin e njësiteve të tjera, si Forcën e Sigurisë së Kosovës

si reagues i dytë apo edhe institucionet e tjera. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve duhet të jetë prioritet qoftë i institucioneve lokale, qoftë i atyre qendrore, duke pasur parasysh rëndësinë e preventimit të situatave emergjente.

Edhe pse ka një kuadër të konsoliduar ligjor, plane dhe strategji të miratuara, kur jemi te gjendja aktuale në terren, në rast të ndonjë fatkeqësie më të madhe natyrore, në këtë rast të ndonjë tërmeti me përmasa të mëdha, reaguesit e parë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme njerëzore, logjistike dhe operacionale, trajnime dhe ushtrime të mjaftueshme, si dhe pajisje dhe mjete të duhura për të reaguar në këso lloj situata, këtu nuk duhet përfshirë FSK-në si reagues i dytë, të cilët kanë njësitë mjaft të specializuara për kërkim-shpëtim urban, si dhe kanë qendrën trajnuese në Pomozotin, në të cilën trajnohen për kërkim-shpëtim edhe disa prej ushtrive fqinje.

Një zjarrfikës si reagues i parë kujdeset përafërsisht për 2 300 banorë (në bazë të Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim duhet të jetë një zjarrfikës për 1 500 banorë), i vogël është edhe numri i automjeteve të tyre, diku rreth një automjet për 10 000 banorë, e mos të flasim për

gjendjen teknike të atyre automjeteve edhe gjendjen aktuale të mjeteve dhe pajisjeve për punë të cilat janë larg standardeve minimale. Gjithashtu, edhe shërbimet mjekësore emergjente nuk është se kanë kapacitete të mjaftueshme për përballje me ndonjë fatkeqësi të përmasave më të mëdha.

Shteti i Kosovës nuk ka asnjë helikopter për ta përdorur në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, edhe pse në disa terrene arritja në cak e automjeteve poseduese në kohë reale është e vështirë e për disa vende duket "mision i pamundur".

Prandaj janë të domosdoshme ngritja dhe zhvillimi i këtyre kapaciteteve, ndarje më e madhe e mjeteve financiare për investime, si dhe janë më së të nevojshme trajnime dhe përgatitje në vazhdimësi, ndërsa ushtrimet praktike të koordinuara të të gjitha institucioneve kompetente janë mënyra më e mirë për të qenë sa më të gatshëm dhe më të përgatitur për t'i përballuar fatkeqësitë e mundshme natyrore.

(Autori është njohës i çështjeve të emergjencave dhe bashkëthemelues i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë - SPRC)

HAPAT QË DUHEN NDËRMARRË NGA TRESHJA KOMBËTARE DHE NDIHMA NDËRKOMBËTARE



Prof. Lisen BASHKURTI

Tragjedia shqiptare ka krijuar dhimbje, por edhe panik në mbarë qytetarët shqiptarë. Por mbi dhimbjen dhe panikun janë humanizmi dhe solidariteti mbarëshqiptar kryq e tërthorë kufijve politikë në mbarë Ballkanin dhe në diasporë që po ngrihen me përmasa të jashtëzakonshme dhe me shpejtësi të paparë. Humanizmi dhe solidariteti për Shqipërinë dhe shqiptarët në këto ditë tragjike po vijnë edhe nga popujt e qeverisë fqinjë, nga

popujt dhe qeveri të shteteve evropiane dhe të ShBA-së. Këto momente po dëshmojnë se Shqipëria dhe shqiptarët nuk janë vetëm. Ato janë pjesë e një bote të qytetëruar të karakterizuar nga humaniteti dhe solidariteti.

Situata aktuale kërkon marrjen e këtyre hapave:

1. Identifikimi sa më i shpejtë dhe i saktë i problemeve në terren. Entet statistikore së bashku me ekspertët duhet të zbresin në çdo familje dhe metër katror të dëmtuar. Identifikimi duhet ta skanojë gjendjen e popullsisë dhe të demit kolateral.
2. Pas identifikimit të problemeve duhet të priorizohen, ato në grup-probleme emergjente, pra afatshkurtra; grup-probleme afatmesme, që lidhen me stabilizimin e përkohshëm të popullsisë së dëmtuar dhe akomodimin e saj; grup-problemet

afatgjata që kanë të bëjnë me rehabilitimin, restaurimin dhe rindërtimin e plotë të situatës.

3. Kërkohet të formulohet dokumenti strategjik i plotë, i cili do ta parashtrijë qëllimin, objektivat, prioritetet, afatet, masat e veprimit që nevojiten të adoptohen nga institucionet politkëbërse dhe vendimmarrëse.
4. Të alokohet buxheti maksimal shtetëror: të mobilizohen burimet njerëzore vendore dhe të huaja; të aktivizohen ose të ngrihen nga e para agjenci ad hoc ose edhe të përhershme publike.
5. Të krijohet strukturë menaxheriale e tipit kompleks treshe: institucionet publike, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Kjo treshe garanton mobilizim burimesh financiare jashtë buxhetore, siguron mirëmenaxhimin e tyre dhe realizon transparencën e plotë dhe të

vazhdueshme të financimeve.

6. Bazuar në identifikimin e problemeve, formulimin e dokumenteve strategjike, adoptimin e tij nga organet vendimmarrëse, alokimin e buxhetit publik dhe përlogaritjes së kontributeve jopublike, mobilizimin e burimeve njerëzore dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale. Është e domosdoshme t'u drejtohem ndihmave ndërkombëtare me kërkesa konkrete, projekte të përgatitura, me parashikueshmëri financiare, ekspertizë teknike e logjistike. Sigurimi i ndihmës ndërkombëtare varet kryekëput nga mënyra se si do të përpilohen kërkesat, projektet, përlogaritjet për financa, burime ekspertize, teknike e logjistike.
7. Zbatimi i plotë dhe në kohë i strategjisë për rehabilitimin, restaurimin dhe rindërtimin e gjithë zonave të dëmtuara, sta-

bilizimin e njerëzve dhe e gjendjes materiale.

8. Kërkohet një analizë e thellë dhe e gjithanshme për politikat zhvillimore të vendit në plane afatgjatë, për parandalimin e minimalizimin e situatave të tilla në të ardhmen, për të hartuar politika, ligje, kode zhvillimore ndërtimore, urbane dhe infrastrukturore, ngritje kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

9. Të përmirësohet sistemi i informim-komunikimit që të sigurohet plotësisht dhe në mënyrë permanente transparenca e opinionit publik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Këta do të ishin disa nga hapat që sugjerohen të ndërmerren nga qeveria dhe institucionet publike, biznesore dhe shoqëria civile me nivel kombëtar dhe atyre ndërkombëtare që do të përfshihen në këtë strategji.

Merkeli do ta vizitojë Aushvicin për herë të parë

BERLIN, 29 NËNTOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel do ta vizitojë për herë të parë ish-kampin e përqendrimit në Aushvic, ka bërë me dije zëdhënësja e saj. Vizita do të zhvillohet të premten e ardhshme, përpara ceremonive përkujtimore me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të kampit nazist të vdekjes. Merkel do të jetë kancelarja e

tretë gjermane, pas Helmut Schmidit dhe Helmut Kohlit, që do të udhëtojë drejt kampit që kanë ngritur nazistët - atëbotë në Poloninë e pushtuar. Vizita e saj bëhet me ftesë të Fondacionit të Aushvicit, i cili shënon dhjetë vjet të themelimit. Në prag të udhëtimit, Merkel dhe kryeministrat e 16 landeve gjermane pritet të konfirmojnë 60 milionë euro donacione për

Fondacionin. Pas vrasjes së një milion hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në periudhën 1940-1945, kampi është bërë simbol i gjenocidit të Adolf Hitlerit ndaj hebrenjve evropianë. Mbi 100 000 njerëz atje po ashtu u zhdukën, përfshirë polakë johebrenj, romë, të burgosur sovjetikë të luftës dhe luftëtarë të rezistencës antinaziste.



Trumpi realizon vizitën e parë në Afganistan

Gjatë një vizite të papritur për Festën e Falënderimeve trupave amerikane në Afganistan, presidenti Donald Trump ka thënë se "talibanët dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje dhe ne do të takohemi me ta dhe ne kemi thënë se duhet të ketë armëpushim dhe ata më parë nuk kanë dëshiruar armëpushim dhe tani duan"



WASHINGTON, 29 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara kanë rinisur bisedimet me talibanët teksa ka realizuar një vizitë të papritur për Festën e Falënderimeve të trupat amerikane në Afganistan, duke shënuar kështu vizitën e parë në shtetin e shkatërruar nga lufta prej kur ka nisur udhëheqjen më 2017. "Talibanët dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje dhe ne do të takohemi me ata dhe ne kemi thënë se duhet të ketë armëpushim dhe ata më parë nuk kanë dëshiruar armëpushim dhe tani duan të kenë armëpushim", u ka thënë ai gazetarëve në veri të Kabulit, ka njoftuar rfe. "Me siguri se do të funksionojë ashtu", ka thënë ai. Udhëtimi i Trumpit vjen një javë pas lirimit të dy pengjeve

perëndimore nga talibanët, në këmbim të tre të burgosurve talibanë, duke rritur kështu shpresat për rikthim të bisedimeve për paqe. Shtetet e Bashkuara dhe talibanët kanë zhvilluar bisedime gati një vit për t'i dhënë fund luftës 18-vjeçare në Afganistan, para se Trumpi t'i pezullonte bisedimet në muajin shtator. Agjencia e lajmeve "Reuters" ka raportuar se zyrtarë talibanë kanë thënë se ky grup është takuar me zyrtarë të lartë amerikanë në Doha në fundjavën e kaluar, duke shtuar se shumë shpejt do të rikthehen bisedimet. "Qëndrimi ynë vazhdon të jetë i njëjtë. Nëse nisin bisedimet për paqe, do të vazhdojnë aty ku janë ndalur", ka thënë zëdhënësi i talibanëve, Zabihullah Mujahid për Reuters, pak pasi Trumpi ka thënë se

bisedimet do të rinisin. Në bazën ajrore në Bagram, presidenti amerikan ka pranuar se numri i trupave amerikane është duke u zvogëluar, mirëpo ka insistuar se SHBA-ja do të vazhdojë të ketë prezencë aty derisa të arrihet marrëveshje apo të ketë fitore, meqë sipas tij talibanët duan që patjetër të ketë marrëveshje. Aktualisht janë rreth 13 000 trupa ushtarake në Afganistan, dhe forca evropiane që marrin pjesë në kuadër të misionit të NATO-s. Ekipi i presidentit afgan, Ashraf Ghani ka publikuar muajin e kaluar një propozim prej shtatë pikave, me qëllim të rikthimit të bisedimeve mes ShBA-së dhe talibanëve. Deri më tani talibanët kanë refuzuar që të bisedojnë me Qeverinë afgane, duke e konsideruar kukull të Perëndimit.

Në Bagram, Trumpi është pritur nga generali ushtarak amerikan, Mark Milley. Presidenti amerikan është shoqëruar nga këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, Robert O'Brien, është takuar me presidentin afgan Ghani, zyrtarët e të cilit kanë thënë se kanë kuptuar për vizitën e Trumpit vetëm disa orë përpara. Lideri afgan ka falënderuar Trumpin për "shtyrje përpara të paqes që do të garantonte arrijtjet e vitit të kaluar dhe do të garantonte siguri". Më vonë, përmes një postimi në rrjetin social, Twitter, Ghani ka thënë se "në takimin tonë bilateral, ne kemi diskutuar përparimin e rëndësishëm që kemi bërë bashkërisht në përpjekjet ushtarake në fushëbetje, duke përfshirë shkatërrimin e grupit

militant, Shteti Islamik në lindje të Afganistanit. Presidenti Trump ka vlerësuar përpjekjet e palodhshme të forcave afgane të sigurisë në këto luftime". "Të dyja palët kanë vlerësuar se nëse talibanët janë të sinqertë në përkushtimin e tyre për arrijtje të paqes, ata duhet të pranojnë armëpushimin. Ne po ashtu kemi vlerësuar se për të zgjatur paqja, strehët e sigurta për terroristët jashtë Afganistanit, duhet të shpërbëhen", ka shkruar Ghani. Gjatë vizitës së tij në bazën ushtarake, Trumpi ka shtruar darkë për trupat amerikane për nder të Festës së Falënderimeve. Presidenti Trump u ka shërbyer ushqim ushtarëve amerikanë për nder të Festës së Falënderimeve. Në këtë festë, që është traditë në ShBA, familjet amerikane darkojnë së bashku.

Kryeministri irakian paraqet dorëheqjen

BAGDAD, 29 NËNTOR - Kryeministri irakian Adel Abdul-Mahdi thotë se do t'i paraqesë dorëheqjen parlamentit të vendit, mes valës së protestave vdekjeprurëse disajavore. Njoftimi i tij të premten u bë pasi kleriku më i lartë shiit i Irakut, Ajatollahu i Madh, Ali Al-Sistani

bëri thirrje për ndryshim në udhëheqjen e vendit. Të paktën 400 vetë kanë humbur jetën dhe qindra të tjerë janë plagosur që kur filluan protestat kundër qeverisë më 1 tetor. Abdul-Mahdi nuk tha se kur do të jepte dorëheqje. Forcat irakiane përdorën armë

zjarri kundër demonstruesve kryesisht të paarmatosur të enjten, duke shkaktuar vdekjen e të paktën 40 personave në një nga ditët më të përgjakshme që kur filluan protestat antiqeveritare muajin e kaluar, siç njoftuan zyrtarët e rendit dhe mjekësisë.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Policia gjermane i bën lutje hajdutëve pas grabitjes më të madhe në botë, 1 miliardë euro

Policia gjermane u ka bërë publikisht një lutje hajdutëve të cilët vodhën stoli me vlerë një miliard dollarë nga një muze. Lutja ndaj hajdutëve është që të bëjnë ç'është e mundur që të mos i shkrijnë objektet me vlerë, por t'i mbajnë ashtu



siç janë. Hajdutët arritën të futen në orët e para të mëngjesit në brendësi të një muzeu në Dresden të Gjermanisë, pasi fikën sistemin e energjisë elektrike, duke çaktivizuar alarmet.

FOTO E DITES



Një djalë dhe një vajzë qëndrojnë para një ndërtese të shembur si pasojë e tërmetit në qytetin e Durrësit. /AFP/

E jashtëzakonshme Deputetët japonezë vendosin "helmeta" në kokë si "stërvitje në rast të tërmeteve"

Politikanët japonezë vendosën helmata plastike të palosshme, në një që po quhet "stërvitje në rast të tërmeteve" në këtë vend. Sipas "Daily Mail", imazhet e transmetuara në televizion dhe media të tjera treguan se si ministri



i Financave, Taro Aso, si dhe ministri i Jashtëm, Toshimitsu Motegi, vendosën me sukses kapelën plastike.

BARSOLETA E DITËS



Një lypës, i cili kërkonte bukë, trokiti në derën e Nastradinit. Nastradini shkoi te nëna që ishte brenda dhe i tregoi.

Nëna:

- Biro, i thuj lypësit nuk është nëna këtu.

Nastradini:

- Po ai nuk po të kërkon ty nënë, por bukë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI


Dielli dhe Plutoni do t'ju bëjnë më optimist

gjatë kësaj dite dhe të gatshëm për të rimëkëmbur gjithçka që keni lënë pas dore.



DEMI

Urani do t'ju stimulojë edhe më shumë dhe do t'ju ndihmojë të tregoheni më të duruar kurdoherë. Nëse keni një lidhje, do të arrini ta përmbani veten.



BINJAKËT

Sot do jeni të mendimit që t'i merrni gjërat si t'ju vijnë. Edhe problemet që do t'ju dalin do të mundoheni t'i zgjidhni me sa më shumë qetësi dhe pa stres.



GAFORRJA

Dinamizmi dhe kuraja do t'ju shoqërojnë gjatë gjithë kohës sot. Ju të dashuruarit do të jeni shumë të dashur me atë që keni në krah.



LUANI

Sot do të keni një mijë e një pyetje si në planin sentimental ashtu edhe në atë profesional, prandaj nuk do të jeni shumë i qetë.



VIRGJËRESHA

Do të jeni në humor të shkëlqyer gjatë kësaj dite dhe gëzimin do t'ua transmetoni edhe të tjerëve. Nëse jeni në një lidhje, keni për të kaluar vetëm çaste pozitive.



PESHORJA

Do të jeni plot energji, besim, dinamizëm dhe kurajë sot. Çdo qëllim që do t'i vini vetes keni për ta arritur. Nëse jeni në një lidhje, edhe sikur të keni shumë kohë bashkë, keni për ta kaluar një ditë vërtet të veçantë sot.



AKREPI

Sot do t'i vini vetes qëllim për të ecur përpara dhe nuk do të ndaleni për asnjë lloj arsyeje. Shokët e vjetër do të kenë mbështetje shumë të madhe.



SHIGJETARI

Sot do të keni shumë shpresa për të ardhmen dhe do të shihni gjithçka me optimizëm. Nga ana tjetër do të jeni mjaft i ndjeshëm dhe i dashur. Tipike për karakterin tuaj.



BRIC-JAPI

Do të jeni i etur intelektualisht dhe seksualisht sot, prandaj do të jeni i gatshëm të provoni e të tentoni gjëra të reja.



UJORI

Ditë sharmante do të jetë kjo e sotmja për ju dhe buzëqeshja nuk do t'ju hiqet nga fytyra. Nëse jeni në një lidhje, do të kaloni orë të këndshme pranë atij që dashuron.



PESHQIT

Mundohuni të jeni më të matur dhe të reflektoni para çdo hapi që do të hidhni. Saturni do t'ju bëjë më të guximshëm. Por, kini kujdes.

Aktorja Susan Sarandon rrëzohet dhe pëson tronditje në tru

Aktorja amerikane Susan Sarandon i ka shokuar fansat me publikimin e fotografive, në të cilat shfaqet me fytyrë të mavijosur. Ajo ka treguar se ishte rrëzuar gjatë një grumbullimi të qytetarëve në New Hampshire, me ç'rast kishte pësuar tronditje në tru.



Rita Ora reagon për festat kombëtare, zgjedh një familje për t'i rindërtuar shtëpinë

Rita Ora, këngëtarja shqiptare nga Kosova, me famë botërore, ka një mesazh për Shqipërinë në ditën e festës kom-

bëtare, por që është tronditur nga tragjedia e rëndë e tërmetit. "Gëzuar ditën e flakurit, Shqipëri. Gjatë ditëlindjes sime, dhe në ditën

e fundit, jam menduar se cila do të ishte gjëja e duhur për të bërë. Bashkë me Erion Veliain vendosëm të zgjedhim një familje të cilën ta

sponsorizojmë e t'i ndërtojmë shtëpinë që i është shkatërruar nga tërmetet në Shqipëri", ka shkruar ajo në rrjetet sociale.

The Weeknd publikon këngë të re

Këngëtari i njohur The Weeknd ka publikuar këngën më të re. Kënga quhet "Blinding Lights". Brenda

pak orëve të publikimit në kanalin "Youtube" ka marrë gjysmë milioni klikime. Kjo këngë është publikuar pa videoklip.



Ava Max arrin një milion ndjekës në "Instagram"



Artistja me prejardhje shqiptare, Ava Max, çdo ditë e më shumë po ngjitet drejt majave të suksesit në tregun ndërkombëtar të muzikës. Këngët e saj janë pëlqyer shumë këtë vit dhe kanë shënuar shifra të larta klikimesh në "Spotify" dhe

"YouTube". Të enjten e datës 28 nëntor, pikërisht në ditën kur shteti i saj amë feston shpalljen e pavarësisë, këngëtarja arriti shifrën e një milion ndjekësve. Këtë gjë ajo e bëri të ditur përmes një imazhi të publikuar në "InstaStory", ku shfaqte shifrat e llogarisë së saj në "Instagram".

Jean Brunhes dhe bisedat me



“Excelsior” ka botuar, të martën e 11 nëntorit 1913, në faqen e dytë, një shkrim në lidhje me udhëtimin e profesorit francez Jean Brunhes në Shqipëri dhe bisedat e tij me Konicën në Durrës, Fishtë në Shkodër dhe Toptanin në Reth.

“Përshtypje nga Shqipëria

Bashkëpunëtori ynë i shquar z. Jean Brunhes, profesor i gjeografisë humane në “Kolegjin e Francës – Collège de France”, i cili vazhdon studimet e tij për vendet e Ballkanit, sapo është kthyer nga një mision i gjatë shkencor në Greqi dhe Shqipëri. Në çdo moment të historisë politike, grupet etnike në gadishull përballen me njëra-tjetrën – siç e kemi parë, natyrisht – në një pozicion dhe qëndrim të ri. Parashikimi i qëndrimit të së nesërme është sekret i të gjithë veprimeve

efikase. Ne e dimë se me çfarë saktësie kishte planifikuar z. Jean Brunhes, tre muaj përpara, luftën e dytë ballkanike dhe fitoren e ushtrive serbe dhe greke. Ai tani përpiket të na shpjegojë Shqipërinë e re, atë që nuk ekzistonte akoma pardje dhe dje; mund të jetë vendi dhe njerëzit mbi të cilët janë publikuar informacionet më të gabuara dhe fantazuese. Pra, kjo ishte një arsye më shumë për të mbledhur këto informacione të dorës së parë dhe të freskëta.

Në Durrës – portin kryesor shqiptar, një qytet i vogël piktoresk që vjen nga Dyrrahu i lashtë i romakëve dhe që ende është i rrethuar nga muret e bukura veneciane – mezi prisja të takoja të shquarin dhe mikpritësin e madh Mehmet bej Konicën; por ai ishte larguar kur unë mbërrita me 16 tetor. Ai ishte larguar një ditë më parë

për në Beograd, i ngarkuar nga miku i tij Esat Pasha me një mision gjysmë-zyrtar pranë qeverisë serbe: nga ky mision mund të dalë një afrim ose të paktën një ‘modus vivendi’ i respektit të ndërsjellë midis Serbisë dhe Shqipërisë.

Pata, të paktën, fatin e mirë të bisedoja me vëllain e Mehmet bej Konicës (autori e ka fjalën për Faik Konicën – v.j.). Ai është një ish-nxënës i Gaston Parisit në Kolegjin e Francës; kishte ardhur për të ndjekur tek ne studime serioze filologjike, në mënyrë që të vinte në pah gjuhën dhe trashëgiminë e çmuar të legjendave dhe ‘folklorit’ të vendit të tij. Ky shqiptar ende i ri, me mendje të ndritshme dhe të mpreshtë, flet shumë mirë frëngjishten dhe disa gjuhë të tjera evropiane.

‘Nëse doni të informoheni për përpjekjet që ne po bëjmë për të ndërtuar një Shqipëri që

mendon dhe funksionon, shkoni të takoni, në Shkodër, një françeskan shqiptar, At Fishtën: ai është poet, filolog, patriot...’

Një bashkëbisedim me At Fishtën

Unë i kisha dëgjuar vetëm emrin At Fishtës; por të dëgjoja lavdërimin entuziast për një murg françeskan nga një shqiptar mysliman shumë i arsimuar, m’u duk diçka e pazakontë, dhe, kështu, unë shkova për të parë At Fishtën në manastirin e tij françeskan në Shkodër.

Një burrë i pashëm me një kokë të madhe, një shikim të drejtë dhe energjik, me flokë të zinj, fytyra e të cilit shpreh një forcë disi të çuditshme që i jep pamjen e një prifti me mustaqe që bien në sy, por pa mjekër (të gjithë priftërinjtë katolikë ser-

bokroatë dhe shqiptarë kanë zakon të rruajnë mjekrën, por të mbajnë mustaqe).

‘Ne kemi bëri, deri më tani, vetëm një jetë individuale dhe krahinore... Lëruni shqiptarëve kohë që të japin provat e tyre... Për pesë shekuj ne u braktisëm deri në tiraninë më të përçmuar dhe madje në barbarizëm... Gjuha jonë ishte e urryer; zakonet tona të vjetra luftoheshin; këto zakone të vjetra, këto kanune, unë do t’i botoj; ne do të shohim se cila ishte drejtësia jonë tradicionale dhe fryma demokratike që ajo kishte... Ne duam së pari autonominë tonë intelektuale...’

Ky njeri fliste me një bindje dhe besim të tillë sa që mora guximin t’i bëj një pyetje të drejt-përdrejtë:

‘Ju e dini se si priftërinj dhe murgj katolikë shqiptarë, ju shohin si agjentë të Austrisë...?’

Fishtën e Toptanin më 1913



Unë do të kujtoj gjithmonë se me çfarë sinqeriteti të drejtpërdrejtë m'u përgjigj françeskani, pa iu shmangur pyetjes dhe pa vështirësi :

'S'është e vërtetë. Ne nuk jemi agjentë të Austrisë. Unë, si dishepull, çfarë do të bëja këtu, nëse do të isha peng i ndonjë fuqie? Ajo që është e vërtetë është se ne dhe Austria kemi pasur interesa paralele. Katolikët shqiptarë kanë simpati për Austrinë, e cila ka mbrojtur dhe mbështetur, ashtu si dikur Franca, kauzën e shenjtit të lirive të tyre fetare: Unë jam drejtori i shkollave katolike të Shkodrës, të cilat financohen nga Austria, por ju siguroj mbi nderin tim që konsullit austriak nuk do të guxonte të më jepte kurrë një urdhër... Ajo që duam, ne shqiptarët, dhe ajo që do të ruajmë kundër të gjithëve, është pavarësia jonë'.

Unë po u dërgoj, si një dëshmitar besnik, këto deklarata të fuqishme.

Françeskani vazhdoi përsëri: 'Na qortojnë për faktin se nuk kemi frymë politike... Por, si mund të kemi një opinion publik disi të organizuar, kur ne jemi të pavarur vetëm prej disa muajsh?... Dhe, prapë, a i përkasim vetvetes?... Është e qartë se jemi të ndarë dhe e injorojmë njëri-tjetrin, por le të na besojnë. Nuk na mungojnë individët që dikur, dhe ende dje, kanë treguar një frymë të madhe politike në Kostandinopojë. Lëruni njerëzve me vlera kohën e duhur që të vihen në pah dhe t'u imponohen natyrshëm shqiptarëve. Ne, pa frymë politike! Por, kedivi i Egjiptit ka gjak shqiptar, dhe politikani i madh Crispi ishte një italo-shqiptar! Ky françeskan, që pretendonte

Crispin për lavdinë politike të Shqipërisë së tij, më dukej gjithnjë e më interesant.

'Gjenerali Esat Pasha e ka treguar veten si një njeri që di të qeverisë. Ne e pamë në aksion gjatë rrethimit të gjatë të Shkodrës. Ai arriti t'u vinte rreth, në këtë qytet shqiptar katolik, 35 mijë turqve pa asnjë incident'.

Rrethimi, megjithatë, ka qenë kaq i gjatë dhe i vështirë! Të gjitha lidhjet (rregullat) e disiplinës mund të ishin dobësuar...

Edhe katolikët shqiptarë kanë shpresë për të ardhmen e vendit të tyre mbi personalitetin e spikatur të pashait, gjeneralit Esat. Po kështu, edhe për shumë shqiptarë myslimanë të Veriut.

Më çuan të takoj Esat Pashën nëpërmjet njërit prej shefave të rajonit malor të Veriut, Basri Beut – një njeri i qetë, i zgjuar, plot kuptim, që është një nga ata për të cilin do të flitet sërish. Basri Beu më duket se është negociatori dhe lideri i kësaj lloj konfederate të Qendrës dhe Veriut, që do të jetë nesër, nëse bëhet realitet, mbështetja dhe forca e Esatit.

Një fjalë nga Esat pasha

Me një qeleshe të kuqe, të vendosur mirë, dhe një xhakë të zezë (e prerë sipas stilit parisian dhe me origjinë po nga Parisi), me një trëndafili të bukur e të zbehtë në xhep, gjenerali, i cili nuk është pesëdhjetë vjeç, duket edhe më i ri se ç'është. Ai është një njeri i aksionit dhe vullnetit, i cili është në moshën e duhur, plot energji. Duket i vendosur se dëshiron të jetë udhëheqësi efektiv i vendit të tij sesa ta braktisë atë ndaj disa burrave për të cilët ka vetëm një konsideratë shumë të ulët.

E di shumë mirë se çfarë bën dhe ku po shkon. I ka prerë urat (lidhjet). Nuk do të ndalet në gjysmë të rrugës.

Ne ishim në Reth më 17 tetor. Procedimet publike dhe deklaratat që janë bërë që nga ajo kohë, Esat Pasha i kishte akoma vetëm në brendësi. Por, ai më tha haptas:

'Tani që jam në krye të vendit tim, jam i lumtur që personi i parë që takoj është një francez'. Unë e shënova fjalinë e tij sa më saktë të ishte e mundur, sipas formës në të cilën m'u përkthye.

Esat pasha qeveris dhe punon. Ai i imponoi vetes mësimin e frëngjishtes. Tashmë e kupton gjuhën tonë; shqipton, me korrigjim, disa fjalë.

Është çorganizues i organizatës së përkohshme. Ai mund të jetë vetëm një i pavarur.

Padyshim që krijimi i një shteti shqiptar të ekuilibruar nuk do të jetë punë e një dite. Sa shekuj iu deshën Francës për t'u bërë Franca? Dhe, pse ëndërrojmë ne, për krijesat e reja politike, një stabilitet ideal dhe përfundimtar që nuk e kanë më të vjetrat e Evropës sonë? Me çfarë iluzionesh harrojmë

papritur gjithë historinë tonë dhe tërë gjeografinë politike! Shqipëria ka ende shumë pengesa, na rezervon shumë surpriza, por lëvizja e mendjeve dhe marshimi i gjërave duket se po shkojnë drejt një fakti që mund të quhet një fakt i ri : pavarësia efektive e një Shqipëri e vërtetë". /Darsiani/

ATDHEUT

*N'ty mendoj kur agon drita,
Kur bylbyli mallshëm kndon
N'ty mendoj kur soset dita
Terri botën kur e mblon.*

*Veç se ty të shoh un n'andërr,
Veç se ty çuet t'kam n'mendim
Ndër t'vështira ti m'je qandërr,
Për ty leht m'vjen çdo ndëshkim.*

*Tjera brigje, fusha, zalle,
Unë kam pa larg tue ba shtek,
E përgjova tjera valle
N'tjera lule syu m'u rrek.*

*Por një fushë ma blerët nuk shtrohet,
Por një mal ma bukur s'rri.
Ma i kulluem një lum s'dikohet,
Moj Shqypni porsi i ke ti.*

*N'ty ma i bukur lulzon prilli,
Jan ma t'kandshme stin e mot,
N'ty bylbyli pa le Dielli
Kndon ma ambël t'Madhit Zot.*

*Pa ty lules s'mi vje era,
Pa ty pema frut nuk m'bjen:
Mue pa ty s'më del prandvera.
Pa ty Dielli nuk m'shkëlxen.*

*Dersa t'mundem me ligjrue,
E sa gjall me frymë un jam
Kurr Shqypni s'kam me t'harrue
Edhe n'vorr me t'përmend kam.*



Poezi nga: Gjergj FISHTA

Naim Frashëri, një koordinatë për të përcaktuar atdheun

Nga: Dorian KOÇI

Çfarë është atdheu? Në ç'formë vjen ai te kujtesa jonë kombëtare? Sa i madh është atdheu? Pyetje që ia bëjmë vetes vazhdimisht, kur meditojmë për vendin tonë, por që u duhet tu japim përgjigje kur na pyesin pafajësisht më të vegjlit, fëmijët tanë.

Çdo vit, duke rrëmuar në kulturën e vendit tënd mund të gesh motive dhe simbole, koordinata dhe drejtime për të përkufizuar atdheun, por besoj se një nga përkufizimet dhe përshkrimet më të mira na e ka dhënë poeti kombëtar, Naim Frashëri te vepra e vet madhore, "Bagëti e Bujqësi", më 1886.

Ai na e paraqet atdheun në fluturimin e një dallëndyshe që e ndalet në çdo qytet të rëndësishëm shqiptar. Poeti kombëtar është një mjeshtër i gjuhës shqipe, sepse kudo ku e ndal fluturimin dallëndysheja, ai përdor dialektin e atij qyteti apo treve. Flurimi i saj fiton në këtë rast një vlerë identifikuese dhe për

brezat tanë një vlerë simbolike që ashtu si dallëndysheja shumë nga këto qytete që janë jashtë kufijve, kanë ditur ti rikthehen etnosit dhe folesë kombëtare. Gëzuar Festën Kombëtare Shqipëri me fluturimin e dallëndysheve që na çon në çdo vatër e qytet të Shqipërisë sonë...

*...Dallëndyshe bukuroshe, që thua mijëra fjalë,
Dhe të k'ënda vahn' e lumën, që vjen me vrap e me valë,
A mos vjen nga Shqipëria? Eni vjen pej Çamërie
Me këto milëra fjalë e me gluhë perëndie?*

*Apo vjen nga Labëria, pra më duke kaqë trime,
Edhe fjalëtë që thua më gëzojnë zëmren time,*

Q'është thier, bërë posi një pasqirë,

Duke këputur nga cmagu, që s'e kanë vartur mirë,

Apo vjen nga fush'e Korçës, nga vënd'i mir' e i gjerë,

Pej zembrësë Shqipërisë, që del gjithë bot' e ndjerë?

A më vjen pej Malësie, pej Skrapari, pej Dobreje,



Nga Vijosa, nga Devolli, pej Vlor' e pej Myzeqeje?

Të munjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti,

Me gas të math do t'i vinjam Shqipërisë brënda në gji!

Për me marrë drejt Shkumbinë edh' Elbasan' e Tiranën,

E me ardh ke ti, o Shkodrë, të shof Drinin e Bujanën,

Kostur, Përlep, Fëllërinë, Dibrë, Ipek e Jakovën,

Mat' e Ysqyp e Prështinë dhe Mirëdit' e Tetovën;

Krojënë e Skënderbegut, q'i ka pas dhan ner Shqypnisë,

Tue bam me trimni luftë, e m'e munt mren e Tyrqisë.

Durres, o qytet i bukur, që je kërthiz' e mëmëdheut!

Edhe ti Leshi me emrë, që ke eshtrat e Skënderbeut!

Burrat tuaj aqë trima do ta lenë vall' Ylqinë

Edhe gjithë shqipëtarët ta mbanjë armiku ynë?

Nukë më ngjan e s'e besonj, kam te zoti shumë shpresë,

Shqipëria këtej-tutje kshu po nukë do të mbesë. /Telegrafi/

Luigj Gurakuqi më 1912: Shqiptarët nuk do të bëhen sllavë



"La Petite République" ka botuar të martën e 19 nëntorit 1912, në faqen e tretë, një shkrim në lidhje me intervistën e Luigj Gurakuqit

dhënë gazetës "Neues Wiener Tagblatt". Shkrimi është si më poshtë.

"Neues Wiener Tagblatt boton një

intervistë të Dr. Luigj Gurakuqit, një shqiptar i shquar, i cili udhëtoi nëpër Vjenë për t'u nisur për në Vlorë. Çështja e Lindjes nuk do

të zgjidhet përfundimisht, thotë ai, nëse Serbia ose Mali i Zi pushojnë qoftë dhe një pjesë të vetme të Shqipërisë. Shqiptarët nuk

duan të bëhen sllavë, ata duan të jenë të pavarur dhe do ta fitojnë pavarësinë ose do të vdesin duke luftuar për të". /Darsiani/

Tërmetet me pasoja tragjike që janë regjistruar në historinë njerëzore

Sipas Sondazhit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara, Enciklopedia Britannica, (11 mars 2011, tërmeti dhe tsumani që preku Japoninë lindore nuk janë përfshirë në këtë listë, sepse vdekjet e shkaktuara, rreth 15,000, janë më pak se ato që vijnë nga tërmetet e listuara më poshtë), tërmeti më shkatërrimtar ka ndodhur në Kinë, në vitin 1556, në të cilin humbën jetën 830 mijë njerëz. Një tërmet tjetër, po ashtu shumë i fuqishëm, që ndodhi në këtë vend më 1976, la të vdekur 655 mijë vetë.

Në vazhdim tërmetet më shkatërrimtare, të shënuara gjatë historisë.

1: Shensi, Kinë, 23 janar 1556 Madhësia rreth 8 ballë, 830,000 vdekje.

Ky tërmet ndodhi në provincën Shaanxi (dikur Shensi), Kinë, rreth 50 milje në lindje-verilindje të Xi'an, kryeqyteti i Shaanxi. Më shumë se 830,000 njerëz mendohet të jenë vrarë. Efektet gjeologjike të raportuara për këtë tërmet përfshinin çarje në tokë, ngritje në sipërfaqe, ulje, rrjedhje dhe rrëshqitje të dheut. Shumica e qyteteve në zonën e dëmtimit raportuan se muret e qytetit u rrënuan, shumica e shtëpive u rrënuan dhe shumë qytete u përmbytën.

2: Tangshan, Kinë, 27 korrik 1976 Madhësia 7.5 ballë. Shifra zyrtare e viktimave është 255,000 vdekje. Numri i vlerësuar i vdekjeve deri në 655,000.

Dëmi shtrihet deri në Pekin. Ky është ndoshta numri më i madh i vdekjeve nga një tërmet në katër shekujt e fundit, dhe i dyti më i madh në historinë e regjistruar.

3: Aleppo, Siri, 9 gusht 1138 Madhësia nuk dihet, rreth 230,000 vdekje.

Llogaritë bashkëkohore thoshin se muret e qytetit të dytë më të madh të Sirisë u shkatërruan dhe shkëmbinj të u kaskonduan në rrugë. Kështjella e Helebit u shemb, duke vrarë qindra banorë. Kryqtarët evropianë kishin ndërtuar një kështjellë në Harim afër, e cila u rrafshua nga tërmeti. Një kështjellë myslimane në Al-Atarib u shkatërrua gjithashtu, dhe disa qytete më të vogla dhe kështjella u kthyen në rrënoja. Tërmeti u tha se u ndje edhe larg Damaskut, rreth 220 milje në jug. Tërmeti i Alepos ishte i pari nga disa që ndodhën midis viteve 1138 dhe 1139 që shkatërruan zonat në veri të Sirisë dhe Turqinë perëndimore.

4: Sumatra, Indonezi, 26 Dhjetor 2004 Madhësia 9.1 ballë, 227,898 vdekje.

Ky ishte tërmeti i tretë më i madh në botë që nga viti 1900 dhe më i madhi që nga viti 1964 Prince Ëlliam Sound, tempulli i Alaskës. Në total, 227.898 njerëz u vranë ose u zhdukën dhe rreth 1.7 milion njerëz u zhvendosën nga tërmeti dhe tsunami pasues në 14 vende në Azinë e Jugut dhe Afrikën Lindore. (Në janar 2005, numri i të vdekurve ishte 286,000. Në prill 2005, Indonezia uli vlerësimin e saj për numrin e humbur me mbi 50,000.)

5: Haiti, 12 Jan 2010 Madhësia 7.0 ballë. Sipas vlerësimeve zyrtare, 222.570 njerëz të vrarë.

Sipas vlerësimeve zyrtare, 300,000 u plagosën gjithashtu, 1.3 milion të zhvendosën, 97.229 shtëpi të shkatërruara dhe 188.383 të dëmtuara në zonën Port-a-Prince dhe në pjesën më të madhe të Haitit jugor. Kjo përfshin të paktën 4 njerëz të vrarë nga një cunami



vendas në zonën e Petit Paradis afër Leogane. Valët e Tsunamit u raportuan gjithashtu në Jacmel, Les Cayes, Petit Goave, Leogane, Luly dhe Anse a Galets.

6: Damghan, Iran, 22 Dhjetor 856 Madhësia nuk dihet, rreth 200,000 vdekje.

Ky tërmet goditi një shtrirje prej 200 milje të Iranit verilindor, me epiqendër direkt poshtë qytetit të Demghan. Shumica e qytetit u shkatërrua, si dhe zonat fqinje. Rreth 200,000 njerëz u vranë.

7: Haiyuan, Ningxia, Kinë, 16 dhjetor 1920 Me madhësi 7.8 ballë, rreth 200,000 vdekje.

Ky tërmet solli shkatërrim të plotë në zonën Lijunbu-Haiyuan-Ganyanchi. Mbi 73,000 njerëz u vranë në Qarkun Haiyuan. Një rrëshqitje në tokë shfarosi fshatin Sujiahe në Qarkun Xiji. Më shumë se 30,000 njerëz u vranë në Qarkun Guyuan. Pothuajse të gjitha

shtëpitë u rrëzuan në qytetet Longde dhe Huining. Kishte një numër të madh rrëshqitjesh të dheut dhe çarje tokësore në të gjithë zonën epiqendrore. Disa lumenj u dëmtuan, të tjerë ndryshuan kursin.

8: Ardabil, Iran, Mars. 23, 893 Madhësia nuk dihet, rreth 150,000 vdekje

Kujtimet për tërmetin masiv Damghan (shih më lart) mezi ishin zbehur kur vetëm 37 vjet më vonë, Irani u godit përsëri nga një tërmet i madh. Këtë herë kushtoi 150,000 jetë dhe shkatërroi qytetin më të madh në pjesën veriperëndimore të vendit. Zona u godit përsëri nga një tërmet fatal në 1997.

9: Kanto, Japoni, 1 Shtator 1923 Magnituda 7.9 ballë, 142.800 vdekje.

Ky tërmet solli shkatërrim ekstrem në zonën Tokio-Yokohama, zjarret e mëpasme dogjën rreth 381,000 nga më shumë se 694,000 shtëpi që

u shkatërruan pjesërisht ose plotësisht. Edhe pse shpesh njihet si Tërmeti i Madh i Tokios (ose Zjarri i Madh i Tokios), dëmi ishte më i rëndë në Yokohama.

10: Ashgabat, Turkmenistan, 5 tetor 1948 Magnituda 7.3 ballë, 110,000 vdekje.

Ky tërmet solli dëme ekstreme në Ashgabat (Ashkhabad) dhe fshatrat e afërta, ku u rrënuan pothuajse të gjitha ndërtesat me tulla, strukturat e betonit u dëmtuan rëndë dhe trenat u shmangen. Dëmtime dhe viktima kanë ndodhur edhe në zonën Darreh Gaz në Iranin fqinj. Këputja sipërfaqësore është vërejtur në veriperëndim dhe juglindje të Ashgabat. Shumë burime rendisin gjithsej viktimat në 10,000, por një njoftim i lajmeve nga qeveria e sapo pavarur më 9 dhjetor 1988, tregoi se numri i saktë i vdekjeve ishte 110,000. (Turkmenistani kishte qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik, i cili prirej të minimizojë numrat e vdekjeve nga katastrofat natyrore të bëra nga njeriu dhe nga ato natyrore. /abcnews.al /



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Futbollistët e Llapit ndihen të fyer nga klubi

Drejtuesit e Klubit të Llapit i kanë akuzuar për rezultate jo të mira futbollistët kryesorë Mentor Zhdrella, Sebino Plaku, Behar Maliqi, Afrim Ademi dhe Labinoti Osmani. Këta futbollistë ndihen të fyer nga këto deklaratë, pasi janë të bindur se gjithmonë e kanë dhënë maksimumin për Klubin e Llapit. Skuadra nga 'Zahir Pajaziti' tashmë është eliminuar nga gara e Kupës, kurse në kampionat ka mbetur dhjetë pikë prapa skuadrës lidere



Mirëpo më pas ka folur trajneri i Llapit, Tahir Batatina, i cili është e ka "zbutur" pak situatën, duke thënë se deklaratat kanë qenë një eufori pas eliminimit nga Kupa. "Ka qenë një eufori pas ndeshjes së Kupës, që është shumë normale, asgjë më shumë", ka deklaruar Batatina.

Skuadra e Llapit ndeshjen e radhës në Superligë e zhvillon në stadiumin "Zahir Pajaziti", nesër (e diel) nga ora 12:55, kundër skuadrës së Flamurtarit. Tri pikë nga kjo ndeshje do t'i këndellnin djelmohat e drejtuar nga Tahir Batatina të dalin nga kjo situatë e rezultateve negative. Në tri ndeshjet e fundit në elitë kjo skuadër ka pësuar dy humbje nga Drita dhe Prishtina, kurse ka luajtur baras me Ballkanin në Suharekë.

ne si futbollistë jemi të fyer nga deklaratat joprofesionale nga ana njerëzve kryesor në klub, sepse ato nuk janë profesionale për

faktin se ne gjithmonë e kemi dhënë maksimumin si në ndeshje, po ashtu edhe në stërvitje", ka thënë një nga lojtarët e Llapit.

Kosova merr programin VAR, Danimarka e përkrah

Gjatë punimeve të "Top Executive Programme" të UEFA-s që po mbahet në Bukuresht të Rumanisë, Federata e Futbollit e Kosovës ka marrë programin për VAR, i cili do të fillojë të testohet në ndeshjet që Përfaqësuesja e Kosovës do t'i luajë si vendëse,

derisa në të ardhmen planifikohet fillimi i kësaj teknologjie edhe në kampionatin vendor. "Me dëshirën që Kosova të vazhdojë këtë organizim të mirë dhe transparencë të FFK-së, por edhe me rezultate të mira të ekipeve kombëtare, shpreh të gjithë simpatinë

time për presidentin Ademi dhe ekipin kombëtar si dhe gjithë popullin futbolldashës të Kosovës. Për këtë arsye kemi zgjedhur Kosovën që ta përkrahim në segmentet ku ajo ka nevojë", ka thënë presidenti i Federatës së Futbollit të Danimarkës, Jesper Moller.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Skuadra e Llapit në këtë edicion të garave nuk ka pasur rezultatet e pritura, pasi është eliminuar nga Digitalb Kupa e Kupës, pasi ka humbur ndeshjen kundër Feronikelit (1-0). Ndërsa edhe në kampionat Llapit nuk i ka punët mirë sepse aktualisht pozicionohet në vendin e shtatë me 10 pikë më pak se skuadra lidere e IPKO Superligës, Ballkani. Për mosrezultate drejtuesit e klubit kanë akuzuar futbollistët me përvojë. Fillimisht trajneri Tahir Batatina, pas eliminimit nga Kupa, deklaroi se ka gabuar nga fillimi i kampionatit që nuk iu ka besuar më shumë futbollistëve të

rinj. Edhe më larg se trajneri ka shkuar nënkryetari i klubit, Amrush Batatina. Ky i fundit ka akuzuar yjet si Mentor Zhdrella, Sebino Plaku, Labinot Osmani e të tjerë si të tepërt në klubin nga Podujeva. "Jo veç lojtarët nga jashtë, por duke filluar nga Sebino Plaku, Mentor Zhdrella, Behar Maliqi, Afrim Ademi, Labinoti Osmani, kanë qenë tepërcë për Llapin dhe duhet shumë shpejt që t'u jepet seanca të rinjve. Ata aty janë veç për lekë e jo për KF Llapin", ka shkruar Batatina. Gazeta të premten ka kontaktuar lojtarët e Llapit, por ai nuk ka qenë i gatshëm të flasë për gazetë. "Nuk po kam dëshirë të flas sepse nuk është situata e mirë në klub dhe çdo deklaratë vetëm e rëndon këtë situatë. Megjithatë,

Rahoveci në Prizren për ta ruajtur vendin e parë

PRIZREN, 29 NËNTOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhironja e 14-t e Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja kryesore do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Rahovecit. Prizrenasit kanë nëntë fitore dhe tri humbje deri më tani, kurse "vreshtarët" janë në vendin e parë me 11 fitore dhe një humbje. "Portokallinjët" kanë treguar lojërë të mira në këtë edicion, kurse rahovecasit synojnë të mbesin në vendin e parë dhe udhëtojnë për fitore në Prizren. Takimi i parë i kësaj xhironje është ndërmjet Feronikelit dhe Sigal Prishtinës. Skuadra nga Drenasi ka tri fitore dhe nëntë humbje në këtë edicion, kurse



prishtinasit kanë shtatë fitore dhe tri humbje në dhjetë ndeshje të zhvilluara. Të dielën ballafaqohen Trepça me Ponte Prizrenin, në një duel interesant, ku mitrovicasit deri më tani kanë dy fitore dhe nëntë humbje, kurse prizrenasit kanë shtatë

fitore dhe pesë humbje. Ndeshja e fundit është ndërmjet Lipjanit dhe Pejës. Lipjanasit kanë 12 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara dhe ende janë në kërkim të fitores së parë, kurse pejanët kanë pesë fitore dhe gjashtë humbje. Golden Eagle Ylli pushon në këtë xhiro.

Superliga - Java 14

Të shtunën takohen:
17:00 Feronikeli - Sigal Prishtina
19:00 Bashkimi - Rahoveci

Të dielën takohen:
17:00 Trepça - Ponte Prizreni
19:00 Lipjani - Peja

Shkëndija ndihmon Shqipërinë

TETOVË, 29 NËNTOR - Fatkeqësia natyrore që goditi Shqipërinë ka solidarizuar jo vetëm shtetet e shumta, por edhe shumë klube futbolli. Edhe pse futboll në Shqipëri nuk do të luhet të paktën deri në javën tjetër, në Maqedoninë e Veriut do të vazhdojnë të luhen normalisht sfidat e javës së 17. Shkëndija do të përballet me Shkupin në shtëpi dhe klubi ka vendosur që të ardhurat nga shitja e biletave të bashkohen me donacionet e lojtarëve dhe kryesisht për familjet e goditura nga tërmeti në Shqipëri. Gjithashtu, klubi në këtë çast ka inkurajuar të gjithë qyte-



tarët që të shkojnë sa më shumë në stadium për të blerë bileta.

Ndeshje humanitare në mes të Yllit dhe Kosovës

SUHAREKË, 29 NËNTOR - Klubi i Basketbollit, Golden Eagle Ylli, në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), të hënën (2 dhjetor) do ta organizojnë ndeshjen humanitare në mes të Yllit dhe

Përfaqësueses së Kosovës në basketboll. Takimi do të zhvillohet në palestrën '13 Qershori' nga ora 19:00. Ndeshja është me karakter humanitar dhe të gjitha të hyrat nga biletat e kësaj ndeshje do të shkojnë për

familjarët e të prekurve nga tërmeti në Shqipëri. Adhuresit e basketbollit në Therandë do të kenë mundësi të shohin një ndeshje atraktive, por edhe të kontribuojnë për familjarët e të prekurve nga

tërmeti në Shqipëri. Ekipi i Kosovës do të përbëhet nga lojtarët e Superligës, derisa trajner do të jetë Bujar Loci. Rezultati në këtë ndeshje është në plan të dytë, por t'i ndihmojë familjet shqiptare që kanë nevojë.



Leclerc, pas përplasjes me Vettelin: Duhet të jemi më pak agresivë

ABU DHABI, 29 NËNTOR - Në prag të garës së fundit sezonale në Abu Dhabi, piloti francez i Ferrarit, Charles Leclerc, është rikthyer të flasë për incidentin e dy javëve më parë në Rio De Janiero, me shokun e skuadrës

Sebastian Vettel. "Më vjen keq për gjithçka që ndodhi atje, por ishte edhe një episod disi i pafat. Kemi rishikuar videon disa herë, bashkë me pjesëtarë të stafit dhe Vettel e di mirë që nuk duhej të s'postohej majtas,

ndërsa unë mund të kisha bërë më mirë për ta shmangur përplasjen. Megjithatë, nuk duhet dhe nuk do të jemi më kaq agresivë me njëri-tjetrin", ka deklaruar Leclerc. "Nuk kemi një hierarki mes nesh, pasi të

dy jemi të fortë mjaftueshëm sa për ta synuar fitoren. Megjithatë, kemi porosi që të mbajmë më shumë distancë me njëri-tjetrin dhe të jemi më pak agresivë", u shpreh Leclerc.



Fetahu: FIBA, krah i fortë i FBK-së në zhvillimin e basketbollit në Kosovë

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, janë prituri në një takim pune në Shtëpinë e Basketbollit në Mies të Zvicrës nga sekretari i Përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis. Në këtë takim Fetahu dhe Dushku kanë marrë lëvdata për punën e madhe që FBK-ja po e bën me gjenerata të reja dhe në veçanti në masivizimin e basketbollit ndër vaxha të reja nëpërmjet projekteve mbështetëse nga FIBA.



Drejtuesit e FBK-së e njoftuan Zagklisin për idenë e Qendrës Kombëtare të Basketbollit të cilin projekt FBK-ja do të fillojë ta implementojë nga viti i ardhshëm dhe me këtë rast FIBA ka shprehur gatishmërinë që të asistojë FBK-në në këtë projekt me trajner me përvojë në implementimin e projekteve të tilla të mëdha. Po ashtu, është diskutuar edhe për tema të tjera si edukimi i trajnerëve në Kosovë, minibasketbolli në Kosovë, ngritja e cilësisë në basketbollin femëror në Kosovë, qeverisja në klubet kosovare, ndërtimi i konceptit të basketbollit 3x3 në Kosovë dhe masivizimi i 3x3 ndër djem dhe vajza të reja. "Takimi ishte mjaft

produktiv. Ne shkuam në këtë takim me ide të qarta se çfarë do të kërkojmë nga FIBA për të na mbështetur në zhvillimin e Federatës, por edhe basketbollit në përgjithësi. Gatishmëria e Zagklis për ta vizituar vendin tonë në vitin e ardhshëm e tregon më së miri vlerësimin që FBK-ja ka marrë nga FIBA", ka thënë Fetahu. Ndërsa Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së, ka deklaruar: "Ne jemi shumë të kënaqur me mbështetjen që e morëm nga FIBA dhe jemi shumë të motivuar të punojmë për zhvillimin e sportit tonë të dashur në vendin tonë së bashku me të gjithë anëtarët e FBK-së. Fokusi ynë në këtë takim ishte në disa tema të rëndësishme së veçantë për zhvillimin e basketbollit në

vendin tonë. Në vitin 2020 ne planifikojmë ta fillojmë implementimin e projektit të minibasketbollit në Kosovë, ndërsa FIBA e vlerësoi shumë një gjë të tillë dhe këtu na premtoi përkrahje të pasqoqë dhe ne jemi shumë të lumtur për një gjë të tillë. Zagklis na përgëzoi për punën dhe vullnetin e madh që e kemi dëshmuar për implementimin e projektit FIBA Europe Girls Program në Kosovë nëpërmjet kampanjës 'Her World, Her Rules', ndërsa ai na ka thënë se bashkërisht tani duhet të fokusohemi për ngritjen e cilësisë së basketbollit femëror në Kosovë dhe këtë do ta bëjmë së bashku nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që do të organizohen në Kosovë në bashkëpunim me FIBA-n".

'Dardanet' e reja mësojnë kundërshtarët për kualifikimet e 'Euro 2021'

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Në selinë e UEFA-s në Nion të premtën është tërhequr shorti për kualifikueset e Kampionatit Evropian 2020/2021 për përfaqësueset e femrave U17 dhe U19. Kosova do të marrë pjesë për herë të parë në këto kualifikime me Përfaqësuesen e femrave U17. Në këto kualifikuese janë gjithsej 12 grupe me nga 4 skuadra, derisa "dardanet" bën pjesë në grupin e 12-të së bashku me Austrinë, Greqinë dhe Lituani. Turneu kualifikues i këtij grupi do të mbahet në Lituani prej 8 deri më 14 tetor të vitit 2020. 28 skuadra do të kualifikohen nga raundi kualifikues në raundin elitë, ku do të jenë 24 skuadrat që do të renditen të



parat dhe të dytat në grupet e tyre respektive si dhe 4 vendet e treta më të mira nga 12 grupet që do ta sigurojnë biletën për kualifikim tutje. Ndërkohë, edhe në kualifikueset e kombëtareve U19, Kosova do të bëjë pjesë në grupin

12, së bashku me Anglinë, Irlandën dhe Greqinë. Turneu kualifikues i këtij grupi do të mbahet në Greqi, prej 21 deri më 27 tetor 2020. Edhe në këtë grupmëshë kualifikimin në raundin elitë e sigurojnë 28 ekepe.

SHKURT

Ademi merr pjesë në mbledhjen 'Top Executive Programme-UEFA'

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, po merr pjesë në mbledhjen "Top Executive Programme-UEFA" që po mbahet në Bukuresht të Rumanisë, e ku është i pranishëm edhe presidenti i UEFA-s, Aleksander Čeferin. Temat kryesore që po diskutohen në këtë takim janë: iniciativat në futboll, avancimi i futbollit të femrave, sidomos promovimi i futbollit te kategoritë e reja. Ndërkohë, gjatë këtij takimi shefi i sektorit të gjyqtarëve në UEFA, Roberto Rosetti, do të flasë për ndarjen e drejtësisë dhe sistemin VAR, si dhe mundësinë e lejimit të një sponsori në fanellat e lojës. Kryetari i FFK-së sot (e shtunë) do të ketë edhe takime të veçanta me zyrtarët e UEFA-s.

Arsenali shkarkon Emeryn

Unai Emery nuk do të jetë më trajner i Arsenalit. Pas 18 muajsh në postin e "topçinjeve", tekniku është shkarkuar zyrtarisht nga posti i tij. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi londinez nëpërmjet faqes zyrtare. Ecuria e dobët e Arsenalit këtë sezon, që vazhdoi edhe mbrëmë në Ligën e Evropës me disfatën me rezultat 2-1, bëri që pasardhësi i Arsene Wengerit, Unai Emery, të shkarkohet nga posti i trajnerit. Në ditët e ardhshme pritet të emërohet edhe tekniku i ri që do ta marrë drejtimin e "topçinjeve".

Formacioni më i mirë i kualifikimeve për 'Euro 2020'

UEFA e ka zbuluar formacionin më të mirë nga ndeshjet e fazës kualifikuese për Kampionatin Evropian 2020. Portier më i mirë ishte Andriy Pyatov i Ukrainës, kurse mbrojtja përbëhej nga Sergio Ramos (Spanja), Merih Demiral (Turqi) dhe Gylfi Sigurdsson (Islandës). Katër mesfushorët janë Ioannis Kousoulos (Qipro), Georginio Wijnaldum (Holandë), Bernardo Silva (Portugali), Eran Zahavi (Izrael). Në sulm, përkrah dy anglezëve Raheem Sterling dhe Harry Kanë, është edhe holandezi Memphis Depay.

Ibra: Milano është shtëpia ime e dytë

Zlatan Ibrahimoviç ka thënë se Milano është shtëpia e tij e dytë, duke nxitur më shumë spekulime për të ardhmen e tij. Klubi i Milanit tashmë i ka ofruar kontratë 18 mujore sulmuesit veteran, ndërsa Bologna është një tjetër klub i interesuar për shërbimet e tij. "Milano nuk është qyteti im i dytë, është shtëpia ime e dytë. Kam kujtime të shkëlqyera nga koha ime atje", ka thënë Ibra për "Gazzetta dello Sport". Edhe pse tashmë është 38-vjeçar, Ibra ka deklaruar se mund të luajë deri në moshën 50-vjeçare nëse ka ndonjë projekt që e stimulon. "Sapo e kam përfunduar përvojën time në Los Anxhelos. Ka qenë fantastike. Tash atje janë dy heronj nga dy botë: unë dhe Giuseppe Garibaldi", ka deklaruar sulmuesi veteran.

Gerrardi: Jam tifoz i Messit, por Van Dijku e meriton 'Topin e Artë'

Legjenda e Liverpoolit, Steven Gerrard, ka thënë se Virgil van Dijk e meriton ta fitojë "Topin e Artë", pasi paraqitet e tij madhështore ndihmuan Liverpoolin ta fitojë Ligën e Kampionëve. Van Dijk është në garë për Topin e Artë këtë sezon, së bashku me Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon. "Po, 100 për qind", është deklaruar Gerrardi në pyetjen nëse Van Dijk meriton "Topin e Artë". "Unë jam tifoz i Messit, sigurisht. E dua atë lojtar. Numra të mëdhenj në lojë e tij për sa iu përket asistimeve dhe golave. Jam një tifoz i tij, pa dyshim. Por nëse flisni për qëndrueshmëri nga një lojtar gjatë një viti, i cili fiton Ligën e Kampionëve dhe është absolutisht i pagabueshëm në çdo paraqitje, kjo do të thotë që ai e meriton të fitojë "Topin e Artë", ka thënë Gerrardi.

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
 Ministria e Shëndetësisë
 Ministarstvo Zdravstva-Sağlık Bakanlığı
 SHSKUK - UBESK - KUHKU
 SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
 "Prim. Dr. Daut Mustafa"
 Njësia Org. I Nr. Prot. 8/47
 Org. Jedinica Br. Prot. 8/47
 Org. Bölümü Prot. No.
 Nr. i faqeve 1 Data: 29.11.2019
 Br. stranica Datum:
 Sayfa no. Tarih: 29.11.2019
 P R I Z R E N



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
 Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
 "Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
 Prizren

Në bazë të nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe shkresës së SHSKUK-së (pranuar në E-mail, datë 20.11.2019), Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2019, nxori këtë vendim:

Përsëritet Konkursi Publik (8/39)

Për pozitat:

1. Mjekë specialist reumatolog - 1 (një) pozitë
2. Mjekë specialistë të emergjencës - 2 (dy) pozita
3. Mjek specialist gjinekolog- 1 (një) pozitë
4. Mjek specialist pediater – i (një) pozitë
5. Zyrtar administrativ- Bachelor i Juridikut – 1 (një) pozitë

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në një mjet të informimit, pikat tjera të konkursit mbeten të njëjta.

U sklado sa članom 13 stav 1.1 Statuta opšte bolnice, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i pismo SHSKUK (primljeno na emailu, dana 20.11.2019), Upravni Savet opšte bolnice "Prim.dr. Daut Mustafa" Prizren na sastanku održanu 29.11.2019 izdao je sledeće odluku:

Ponavlja se Javni Oglas (8/39)

Za pozicije:

1. Lekar specijalista reumatolog - 1 (jedna) pozicija
2. Lekar specijalista emergencije - 2 (dva) pozicije
3. Lekar specijalista ginekolog - 1 (jedna) pozicija
4. Lekar specijalista pedijatar - 1 (jedna) pozicija
5. Administrativni sluzbenik: 1 (jedna) pozicija

Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od medija, ostale tačke ostaju iste.

Hastane Statüsü'nün 13'üncü maddesinin 1.1 fıkrasına göre, Konkur işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin desteğiyle, aynı zamanda HKUK'nin mektubuna (20.11.2019 tarihinde kabul edilen e-postasına) dayanarak, Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Yürütme Kurulu 29.11. 2019 tarihli toplantısında şu kararı verdi:

İş ilânının tekrarı (8/39)

Konumlar:

1. Uzman doktor - reumatolog: 1 konum
2. Acil tıp uzmanı: 2 konum
3. Uzman doktor - Jinekolog: 1 konum
4. Uzman doktor - Çocuk doktoru: 1 konum
5. İdari Görevli - Hukuk Fakültesi Lisansı: 1 konum

İlan, medya kuruluşunda yayınlanmasından 15 gün açık olacaktır, ilanın diğer noktaları aynı kalacaktır.

Drejtoresha e Administratës
 Ma. Sci. Melinda Çollaku



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
 Ministria e Shëndetësisë
 Ministarstvo Zdravstva-Sağlık Bakanlığı
 SHSKUK - UBESK - KUHKU
 SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
 "Prim. Dr. Daut Mustafa"
 Njësia Org. I Nr. Prot. 8/48
 Org. Jedinica Br. Prot. 8/48
 Org. Bölümü Prot. No.
 Nr. i faqeve 1 Data: 29.11.2019
 Br. stranica Datum:
 Sayfa no. Tarih: 29.11.2019
 P R I Z R E N



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
 Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
 "Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
 Prizren

Në bazë të nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe shkresës së SHSKUK-së (pranuar në E-mail, datë 20.11.2019), Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2019, nxori këtë vendim:

Përsëritet Konkursi Publik (8/40)

Për pozitat:

1. Mjekë specialistë patolog - 1 (një) pozitë
2. Mjekë specialistë fizioter - 1 (një) pozitë

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në një mjet të informimit, pikat tjera të konkursit mbeten të njëjta.

U sklado sa članom 13 stav 1.1 Statuta opšte bolnice, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i pismo SHSKUK (primljeno na emailu, dana 20.11.2019), Upravni Savet opšte bolnice "Prim.dr. Daut Mustafa" Prizren na sastanku održanu 29.11.2019 izdao je sledeće odluku:

Ponavlja se Javni Oglas (8/40)

Za pozicije:

1. Lekar specijalista patolog - 1 (jedna) pozicije
2. Lekar specijalista fiziatar - 1 (jedna) pozicije

Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od medija, ostale tačke ostaju iste.

Hastane Statüsü'nün 13'üncü maddesinin 1.1 fıkrasına göre, Konkur işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin desteğiyle, aynı zamanda HKUK'nin mektubuna (20.11.2019 tarihinde kabul edilen e-postasına) dayanarak, Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Yürütme Kurulu 29.11.2019 tarihli toplantısında şu kararı verdi:

İş ilânının tekrarı (8/40)

Konumlar:

1. Uzman doktor – patolog – 1 (bir) konum
2. Uzman doktor – fiziatr – 1 (bir) konum

İlan, medya kuruluşunda yayınlanmasından 15 gün açık olacaktır, ilanın diğer noktaları aynı kalacaktır.

Drejtoresha e Administratës
 Ma. Sci. Melinda Çollaku



Request for Expression of Interest

Country: Kosovo
 Project ID: P147402
 Contract Identification No.: Ref. No.: 2.2.1
 World Bank Loan/Credit Name: Kosovo Health Project

Technical Audit / Administrative data verification for the Capitation Based Performance Payment Scheme – 2018-19**Background:**

On March 26, 2015 the Assembly of Republic of Kosovo approved the Financial Agreement between the Kosovo Government and the International Development Association. The Kosovo Health Project (KHP), restructured in May 2018, is worth US\$ 15.69 million. Its objective is to contribute to (i) developing the building blocks to introduce Social Health Insurance (SHI); and (ii) strengthening primary health care (PHC) in selected municipalities.

The project consists of three components:

- Component 1: Establishing building blocks for the introduction of SHI.
- Component 2: Strengthening PHC in selected municipalities.
- Component 3: Project management and communications.

Overall objective of the assignment

The overall objective of this assignment is to carry out an independent technical audit to verify the number of patients registered in the Avicenna / web-based HISs with a personal identification number as of December 31, 2018, and as of June 30, 2019..

Scope of work:

Under these TORs, the consulting firm will:

- Carry out a systematic random sampling methodology in each of the municipalities, using the MoH's list of patients registered with a personal ID number in the Avicenna / web-based HISs as of December 31, 2018 and as of June 30, 2019. For each municipality, 100 registered patients will be selected randomly. If there are less than or around 100 registered patients, then all registered patients will be selected. The firm will consult with the client on the exact details for the systematic random sampling process.
- Randomly select sampled patients. Since the phone number will not be available for some initially selected patients, the consulting firm will continue to select randomly patients until they reach the right number of selected patients for whom a phone number has been entered.
- Prepare the interview guide for enumerators.
- For each selected patient, call and ask the patient to confirm if he/she is effectively a patient of public primary health care facilities in the municipality.
- Replace patients who do not answer after callbacks with other randomly selected patients.
- Ensure quality data through standard supervision and quality control measures including a sample of random callbacks and tracking of enumerators, and data entry program including automatic consistency and range checks.
- Seek to explain any discrepancy found between the MoH's data and the audit data.
- Prepare audit report for a non-technical audience.

Qualifications and experience of the Consultant:

The Ministry of Health would like to contract a consulting firm with:

- Demonstrated experience in similar verification / technical audits over the past five years;
- At least five years' experience in surveys;
- Availability of staff with professional qualifications and technical abilities.

Eligible consulting firms will be valued and shortlisted according to the above mentioned.

The team of experts proposed by the Consultant shall include the following key members:

Team leader:

- University degree in social sciences specialized in statistics or other relevant areas;
- Over 10 years of experience in conducting surveys;
- Demonstrated experience in preparing survey samples;
- Demonstrated experience in survey manual development and enumerator training and supervision;
- Demonstrated experience in drafting survey reports for a non-technical audience;
- Fluent knowledge of English.

Enumerators:

- University degree in social sciences;
- At least three years' experience in conducting surveys;
- Fluent in Albanian and Serbian languages.

Selection process:

Consultant will be selected in accordance with the procedures set out in the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers published in January 2011 (Consultants Guidelines), according to selection based on **Consultants Qualifications (CQ) method**.

Selection criteria for shortlisted companies

The companies will be evaluated based on following criteria:

- Experience in social science, statistics and surveys (50%)
- Relevant work experience in implementing similar projects (30%)
- Availability of qualified staff within the firm (20%).

Interested firms may obtain further information for this assignment at the e-addresses during office hours: 08:00 - 16:00 hrs (Monday to Friday):

Expression of interest may be submitted to the below stated address until **December 13, 2019**

Ministry of Health,

Afrim Bajrami, Procurement Specialist
 Address: Ministry of Health Rr. Zagrebit p.n.
 10 000 Prishtinë, Republic of Kosovo
 E-mail: To : afrim.bajrami@rks-gov.net
 E-mail: Cc : Fatime.Arenliu.Qosaj@rks-gov.net

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arsim Bilalli shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 70920573 Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

RESTAURANT

**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/giejpuneshpejta



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906